

GABRIEL DARA (I RIU)

**KENGA  
E SPRASME  
E BALES**

BIBLIOTEKA

814 1

824

**POEME**

1985  
Gjurmë të  
24 Tetor  
1998-1999

## NJË KRYEVEPËR E POEZISË SONË

(Kënga e sprasme e Balës)

Si të jetë historia e një populli e atillë është edhe letërsia e tij. Letërsia jonë kombëtare e së kaluarës dhe e kohës së sotme e provon më së miri këtë të vërtetë pasi në të ka lënë gjurmë të pashlyeshme historia jonë shumë-shekullore e mbushur me luftra heroike e me përpjekje të mëdha për të ruajtur vetveten, për të fituar lirinë, për të mbrojtur dinjitetin kombëtar dhe për të çarë përpara të papërkulur përmes dallgëve e rrebesheve të panumërta. Historia jonë kombëtare ka qenë një histori luftërash dhe heroizmash, në të cilat është kalitur një karakter i papërkulur, liridashës dhe krenar, janë rrënjosur ndjenjat e burrërisë e të drejtësisë, të atdhedashurisë e të sakrificës, të përparimit e të krenarisë kombëtare, të urrejtjes së papërmbajtur kundër armiqve dhe të miqësisë për popujt e tjerë. Si në një vazhdimësi të pandërprerë në historinë e popullit tonë e kaluara e lavdishme ka ushqyer kohët më të vona dhe këto janë prirë drejt së ardhmes, duke sjellë deri në ditët tona faqet më të ndritura dhe figurat



më të shquara, të cilat janë bërë elemente të ndërgjegjes kombëtare socialiste, duke u pasuruar me tiparet e reja të njerëzve të epokës së socializmit. Për këto arsye letërsia shqiptare e së kaluarës dhe e ditëve tona ka pasur dhe vazhdon të ketë një theks të dukshëm patriotik revolucionar dhe në shumë vepra të shkrimtarëve të të gjitha kohëve, së paku që nga Marin Barleti e këtej, u është kënduar me frymëzim heronjve dhe heroizmave, vitalitetit të rrallë të një populli të vogël, që ka qenë dhe mbetet i vendosur të mbrojë vetveten, tokën dhe lirinë e tij pa marrë parasysh asnjë sakrificë dhe pa llogaritur asnjë armik, sado i fuqishëm, i egër e dinak që mund të ketë qenë ai. Me besim të patundur në forcat e veta dhe në drejtësinë shekullore të çështjes për të cilën ka luftuar e lufton, populli ynë, jo vetëm nuk u është shmangur vështirësive e sakrificave, por, edhe në momentet më të rënda dhe më tragjike të historisë, siç është vënë re me kohë, ai kurrë nuk ka vajtuar për disfatat dhe për humbjet, po u ka kënduar trimërive dhe heroizmave të veta dhe ka manifestuar kështu, jo vetëm epërsinë morale mbi armiqtë po edhe dëshirën dhe besimin e përtëritjes së vazhdueshme e gjithnjë më të lartë të epopeve më të lavdishme deri në fitoret përfundimtare.

Letërsia e Rilindjes kombëtare është një shembull i madh i pasqyrimin të këtij shpirti përjetësisht të pamposhtur të popullit tonë. Në këtë letërsi me frymë të dukshme patriotike, popullore, romantike, «Kënga e sprasme e Ballës» e Gavril Darës ze një vend të nderuar. Ajo, për vlerat

e saj ideoartistike, ruan edhe sot e kësaj dite rëndësinë e një kryevepre të poezisë sonë.

Si lindi kjo kryevepër?

«Kënga e sprasme e Balës» duhet të ketë qenë e përfunduar në vitin 1885, po u botua më vete më 1906, pas vdekjes së autorit. Pra, ajo është shkruar në një kohë kur lëvizja çlirimtare shqiptare kishte marrë hov të madh dhe letërsia jonë kombëtare kishte njohur veprat e mëdha të De Radës dhe të Naim Frashërit, ishte krijuar shtypi shqiptar dhe botimet në gjuhën shqipe nuk ishin më diçka e rrallë, përkundrazi ato kishin tërhequr vëmendjen e patriotëve dhe të miqve të Shqipërisë. Letërsia artistike, krahas studimeve gjuhësore, folkloristike dhe historike, po bëhej një mjet me rëndësi për zgjimin e ndër-gjegjes kombëtare të popullit dhe për njohjen e çështjes shqiptare në arenën evropiane. De Rada, Kamarda, Santori etj, kishin shtruar sheshin e veprimit patriotik e letrar edhe në «arbëreshët e Italisë», të cilët megjithëse, siç thotë me keqardhje Serembja, nuk lindën në Shqipëri, trashëguan nga paraardhësit ndjenjën e dashurisë për «dheun e të parëve». Kjo është një dashuri tronditëse, siç është zakonisht dashuria e të mërguarve patriotë për vendin e tyre. Si minoritet i krijuar në rrethana të jashtëzakonshme e tragjike, arbëreshët e Italisë mbetën për një kohë të gjatë të varfër, të veçuar prej vendasve, të mbledhur rreth njëri-tjetrit, të lidhur ngushtë me të kaluarën e tyre dhe të vendit të tyre dhe me shpresën e organizimit të



një fushate luftarake, që do t'i kthente përsëri në Atdhe. Gjuha, zakonet, mënyra e jetesës mbaheshin prej tyre si gjëra të shenjta, kurse kujtimet e të kaluarës, me rrjedhjen e kohës, përpunoheshin dhe merrnin formën artistike të gojdhënave, të legjendave e të këngëve popullore, disa prej të cilave janë shumë të vjetra kurse një pjesë e madhe, siç duket, është krijuar ose edhe rikrijuar pas shpërnguljeve. Nota e mallit dhe e një brengje të fshehur për të kaluarën dhe për vendin e të parëve përzihet në këto këngë në forma shumë të natyrshme dhe origjinale me krenarinë për «bijtë e motit të madh», që «hapën një të madhe udhë» për Shqipërinë. Skënderbeu dhe koha e tij janë për këtë letërsi popullore, si për vetë formimin shpirtëror të arbëreshëve, një prej elementeve më me rëndësi, ku heroika është përzier me tragjiken dhe me një nostalgji të thellë lirike, që japin poezisë arbëreshe atë formë të njohur origjinale prekëse e ndikuese, të cilën nuk mund ta kishte poezia tjetër shqiptare, edhe kur u krijua prej poetësh të mërguar si Filip Shiroka me shokë. Një tjetër realitet lind të tjera ndjenja e mendime, të tjera qëndrime e këto s'ka se si të mos reflektohen në fizionominë e letërsisë, kur arrihet një shkallë e lartë e ndërgegjjes kombëtare e shoqërore.

«Kënga e sprasme e Balës» është fryt i këtyre kushteve dhe i këtyre traditave të jetës e të poezisë arbëreshe. Me të drejtë në të gjitha studimet e derisotme nuk është pranuar versioni romantik i paraqitur prej Gavril Darës në parathënien e poemës, sipas të cilit ajo jepet si pjesë

e nje eposi të madh e të lashtë popullor, po nga ana tjetër lidhjet e kësaj poeme me traditën e me natyrën e poezisë popullore nuk do të ishte me vend të shiheshin vetëm në disa elemente të jashtme, siç janë disa personazhe, disa motive të huajtura nga poezia popullore dhe mjaft elemente të stilistikës poetike. Duke qenë anët më të dukshme të lidhjeve të poemës me poezinë popullore, ato nuk janë ana më themelore dhe më me rëndësi e këtyre lidhjeve dhe zor se mund të mendohet që Dara ka bërë një punë me kast për t'iu përqsaur folklorit. Poema, megjithëse në të gjejmë edhe reflekse të kulturës letrare të autorit, që ka provuar të shkruaj vargje edhe në italisht, në themelet e veta është konceptuar sipas traditës së poezisë popullore dhe origjinaliteti i saj artistik nuk përmbahet në ndonjë kombinim mekanik të kësaj tradite me elementet romantike e klasiciste, që do të kishte qenë artificiale, po në shkrirjen e natyrshme të elementeve epike në elementet lirike, siç e gjejmë këtë edhe në poezinë popullore arbëreshe. Kjo veçori na duket se ka të bëjë si me largësinë në kohë të tematikës së trajtuar (po të vihet re në poezinë popullore arbëreshe ka pak motive nga jeta e tyre pas shpërnguljes), edhe me ndarjen prej vendit dhe prej aktualitetit të tij të drejtpërdrejtë. Edhe vënia përballë e ndjenjave intime me ndjenjën e detyrës është një element që e ka zanafillën pikërisht në poezinë popullore, kështu që tradita e klasicizmit nuk mund të merret si shkak i parë i saj, po vetëm si një shtytje e re për të parë e për të vlerësuar diçka që ka ekzistuar para saj dhe



që vetë letërsia e klasicizmit e ka huajtur prej lashtësisë. Një poet i talentuar, siç qe Dara, kur i është vënë punës për të krijuar poemën me temë nga një epokë e lavdishme shqiptare dhe me qëllime të përcaktuara kombëtare ka menduar seriozisht edhe për fizionominë artistike të saj, që nuk mund të ishte ajo e letërsisë që ai njihte, po diçka tjetër. Dhe për të arritur një qëllim të tillë ai kishte në zotërim traditën e pasur të poezisë popullore, që duket se e njihte shumë mirë dhe e kishte për shpirt, kishte gjithashtu edhe përvojën e mjeshtëreve të tjerë arbëreshë, sidomos të De Radës e të Santorit, nga të cilët duket se ka përfituar, po edhe ka arritur të japë diçka të vetën, që e dallon jo vetëm prej tyre, po edhe prej të gjithë poetëve të tjerë shqiptarë. Prandaj na duket e arsyeshme të themi se krijimi në frymën dhe në konceptimin e përgjithshëm të poezisë popullore ka qenë në natyrën e punës krijuese të Darës, në bazën e konceptimit dhe të realizimit të veprës së tij. Kjo duket fare qartë sidomos po t'i marrim veç e veç këngët e poemës dhe t'i krahasojmë për natyrën e tyre me rapsoditë popullore arbëreshe. Shfrytëzimi i personazheve të poezisë popullore, i motiveve të nxjerra prej saj si dhe i figurave artistike etj. janë elemente plotësuese, të cilat do të tingëllonin disi artificiale e letrëske, në qoftë se themelet e veprës nuk do të kishin qenë të hedhura në truallin e poezisë popullore.

Edhe karakteri romantik i poemës nuk na duket i largët nga fryma që sundon në një pjesë të mirë të poe-

zisë popullore arbëreshe, ku vetë harmonizimi i elementeve epike me ato lirike i lëshon vend futjes së botës subjektive dhe shfaqjes së saj goftë edhe në mënyrë të tërthortë, si nëntekst i këngëve dhe i rapsodive. Pastaj ndërmjet romantizmit të letërsisë së periudhave të lëvizjeve kombëtare dhe krijimtarisë popullore nuk është e udhës të krijohen kundërvënie, pasi dihet mirë interesimi i poetëve të këtyre periudhave për traditën popullore, në të cilën gjendet një mbështetje e fortë për afirmimin e aspiratave kombëtare. Prandaj romantizmi në këtë rast shpesh shfaqet pikërisht në mbështetjen, në shfrytëzimin krijues dhe në krijimin sipas traditës popullore dhe nuk kemi të bëjmë me ndonjë raport të jashtëm ndërmjet tyre. Romantizmi i Darës është një romantizëm popullor në brendi dhe në formë dhe poema e tij, ashtu siç ka një brendi thellësisht patriotike, ashtu ka edhe një formë artistike me veçori të dukshme kombëtare popullore. Me të drejtë janë vënë re në poemë edhe refleksë të letërsisë kalorsiake (shtegtimi i dy trimave në kërkim të lavdisë) apo edhe të poemave të Homerit (përshkrimi i Skënderbeut dhe i bashkëlufëtareve të tij), po këto nuk ngrenë peshë të madhe dhe si motive nuk janë të huaja edhe për poezinë popullore (motivi i grindjes së dy trimave për një vajzë).

Është e kuptueshme, dhe gjithë letërsia e Rilindjes e provon, se pa lëvizjen e gjerë të ndërgjegjshme të çlirimit kombëtar nuk mund të lindte një letërsi kombëtare, nuk mund të krijoheshin vepra si ato të De Radës e të Naimit,



ose poema të shquara si «Kënga e sprasme e Balës». Kjo lëvizje është frymëzuesja dhe nxitësjë e letërsisë kombëtare. Ajo, nga një anë, bëhet objekt i kësaj letërsie me bukurinë dhe madhështinë e vet heroike dhe i jep drejtimin asaj me aspiratat dhe idealet e veta, nga ana tjetër ka nevojë për këtë letërsi, si mjet për afirmimin e vetvetes, për përhapjen e aspiratave e të ideve të veta. Te arbëreshët e Italisë ndikimi i lëvizjes kombëtare shqiptare ka qenë shumë i fortë, ndryshe në shekullin e nëntëmbëdhjetë nuk do të kishte qenë e mundur të zhvillohej ajo lëvizje politike e letrare kombëtare, që dha kontribut të çmuar dhe krijoi vepra të mëdha pas pesëqind vjetësh mërgimi. Ndjenja e vetëruajtjes, që bëri të mbahen gjallë deri në ditët tona gjuha, zakonet dhe elemente me rëndësi në mënyrën e jetesës, ka vlerën e vet të madhe në këtë mes, po ajo do të mbetej një faktor në potencë, që do të vinte duke u dobësuar, në qoftë se nuk do të merrte zjarr lëvizja shqiptare e çlirimit kombëtar, gjersa një lëvizje e tillë s'kishte si të lindte në terrenin arbëresh veçse si një lëvizje letrare në kuptimin e gjerë të fjalës (artistike, publicistike, shkencore). Se sa i fortë ka qenë ky ndikim e tregojnë shumë fakte e, ndër këto fakte, vlen të përmendet si një rast tipik edhe «Kënga e sprasme e Balës». Gavril Dara (I Riu) nuk ishte njeri pa rëndësi në jetën shoqërore, politike dhe kulturore të Italisë. Ai mori pjesë vepruese në lëvizjen revolucionare të bashkimit e të çlirimit të Italisë, pati vende drejtuese në administratën lokale të pushtetit të lindur nga kjo lëvizje, drejtoi

disa vjet një gazetë me rëndësi, kishte interesa të gjera kulturore, shkroi edhe vjersha në italisht. Pse, atëherë, iu vu punës për të shkruar shqip një poemë, në qoftë se nuk ka shkruar edhe gjë tjetër? Pse, gjithashtu, si në këtë poemë dhe në të gjithë letërsinë arbëreshe sundon tema shqiptare (dhe në temën shqiptare lakmohet epoka e Skënderbeut), dhe jo tema e jetës së vetë arbëreshëve apo e lëvizjes revolucionare italiane, në të cilën edhe vetë poetët tanë arbëreshë morën pjesë vepruese? Zor se mund t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve pa mbajtur parasysh se faktor kryesor për një gjë të tillë ka qenë lëvizja kombëtare shqiptare, që vuri në rend të ditës çështjen e çlirimit të Atdheut, të aleatëve dhe të armiqve në këtë luftë si dhe domosdoshmërinë e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare për të cilën traditat e lavdishme kanë rëndësi të dorës së parë. Vetë Dara, si dhe arbëreshët e tjerë, u interesua drejt për drejt për këto çështje dhe një dëshmi e qartë për këtë janë mendimet e shprehura në parathënien e poemës ku del gjithashtu se lëvizja revolucionare italiane nuk ka qenë nxitja kryesore, po vetëm një shembull nga mund të nxirreshin mësim të dobishme për forcimin e bashkimit kombëtar dhe sigurimin e një udhëheqjeje të sigurtë të luftës, siç pat qenë dikur Skënderbeu. Aq më tepër se lëvizja për bashkimin e Italisë është pothuajse e një kohe me lëvizjen tonë kombëtare. Përsa u takon ndikimeve të romantizmit evropian etj. ato, sado të vërteta të jenë (edhe Naimi i kërkon huret te Lamartini) janë vetëm mbështetje artistike për disa aspirata, rrënjët e të cilave



janë hedhur në terrenin e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe të krijimtarisë letrare të popullit tonë. Nuk është e rastit që romantizmi ynë, edhe ai i poetëve arbëreshë, ka veçori që e dallojnë mirë prej romantizmit evropian, si për motivet që vihen në themel të veprave dhe për realitetin që pasqyrohet në to, edhe për format origjinale kombëtare të manifestimeve të tij. Vetëm disa poetë të dorës së dytë, kryesisht klerikë, bëjnë përjashtim nga ky rregull pothuajse i përgjithshëm. Poema e Darës edhe në këtë drejtim është një ndër shembullat më të qarta. Ajo, me të gjitha vlerat dhe veçoritë e saj, dëshmon se është pikërisht lufta çlirimtare e popullit faktori kryesor i forcimit të ndërgjegjjes kombëtare, i përtëritjes së shpresave për një të ardhme të lirë dhe, mbi këto baza, edhe i lindjes së këngëve frymëzuese e kushttrimtare.

Dara e dëshmon vetë këtë të vërtetë, jo vetëm me brendinë dhe me formën e poemës, po edhe me mendimet e shprehura në parathënien e saj, ku del qartë se ai e ka shkruar poemën në shërbim të drejtpërdrejtë të qëllimeve dhe të idealeve të lëvizjes së çlirimit kombëtar. Ai shfaq dëshirën që poema të jetë për shqiptarët *«dhjatë e bashkimit, flakë e lirisë, verigë e dashurisë për të lidhur të gjithë vëllezërit që flasin një gjuhë, që njihen të lindur një gjaku...»*. Këngët ai i krahason me flamurët e luftës që mbledhin rreth vetes ushtarët e shpërndarë. Ato janë *«drita ku çelen zemrat e të urtëve, shenja e kombësisë, flamuri i nderit, dhjata e prindërve»*.

11

Nga këto fjalë del fare qartë se poema nuk lindi as rastësisht, as si fryt ndikimesh të huaja shoqërore e letrare. Ajo lindi nën shtytjen që kishte marrë lëvizja jonë kombëtare dhe u mbështet në ato momente të historisë së popullit, që mund t'i shërbenin kësaj lëvizjeje si flakë frymëzimi dhe si flamur lufte. Pra, megjithëse trajtonte një temë historike, poema, për kohën kur u shkrua, kishin një tingull të fuqishëm aktual, që në disa vargje, siç është provuar edhe tjetër herë, del edhe më i drejtpërdrejtë. Të tilla janë vargjet në të cilat Bala u drejtohet bijve të motit të madh, që «*çelën një të ndritur udhë*», apo ekzaltimi në vargjet e këngës së parë të pjesës së dytë, në të cilat del bindja se Shqipëria nuk do të humbasë kurrë në errësirë «*se edhe e coptuar dhe e shtypur — me dritë botën do të mbulojë*».

Prej kushteve në të cilat u shkrua janë përcaktuar edhe disa veçori dalluese të brendisë ideoemocional të poemës, sidomos shkrirja në të e elementeve epiko-heroike, lirike dhe tragjike si dhe shikimi i mallëngjyer i së kaluarës nga një pjesëmarrës i ngjarjeve që përshkruhen.

Pse Dara krijoi për frymëzimin e vet një *ndërmjetës* si plaku Balë? A ka të bëjë ky krijim vetëm me ato që thuhën në parathënie apo personazhi i krijuar ka një rëndësi më të madhe ideoemocionale? Po ta marrim nga ana e vërtetësisë historike askush nuk do të kishte kundërshtim t'i merrte për letërsi dhe t'i integronte në brendinë e jashtvendosur të poemës edhe ato që thuhën në parathënie për



plakun Balë, i cili nuk del në poemë vetëm në ato raste kur flitet për të (këto janë raste fare të pakta), po është i pranishëm kudo, pasi ai është syri me të cilin poeti ka parë e pasqyruar të kaluarën, është ndërgjegjja e luftëtarit në të cilën reflektohet kjo e kaluar, është dashuria, dhimbshuria dhe krenaria për bashkëluftëtarët, është dhimbja e thellë për humbjet e për ngjarjet tragjike, është dëshpërimi i atij që ka luftuar dhe jo vetëm nuk ka realizuar idealet e veta, po është i detyruar të rrojë larg vendit duarlidhur dhe gjen ngushëllim vetëm duke rijetuar në kujtesë, kohërat e lumtura të luftës. Nuk është nevoja të themi këtu më tepër nga ç'ka thënë Dantia për një rast të tillë: *«Dhimbje më të madhe nuk paska, se të kujtosh kohën e lumturisë në mjerim e në vaj»*. Nga kjo pikënisje e autorit lexuesi duhet ta kërkojë Balën në të gjithë poemën dhe, me që nuk e gjen të pranishëm fizikisht, do ta gjejë patjetër në frymën e poemës, në nëntekstin e saj, në subjektivitetin e pasqyrimeve poetike. Po edhe me kaq çështja e Balës nuk mbaron, se lindin edhe dy pyetje të tjera: a ka anë të përbashkëta dhe dallime ndërmjet Balës dhe autorit? A është pasur në çdo çast parasysh Bala si tregimtar i ngjarjeve në poemë?

Le të marrim në ndihmë parathënien. Atje është shkruar:

*«Ati birit e biri nipit i rrëfyeu punët e shkëlqyera dhe luftat e ndershme, që u luftuan në kohën e Skënderbeut; se atëherë vetëm për së pari dhe, ajme, për të fundit herë, gjithë bujaria, gjithë trimëria e Arbrit, burra e*

gra, pleq e të rinj, patën një zemër, duke dashur nderin dhe lirinë e tokës që i lindi dhe ç'donte njeri e donin të gjithë.

Prandaj, nga bashkimi i shenjtë, lindi fuqia që për njëzet e pesë vjet theu fuqinë e turqve dhe përpiu njëra pas tjetrës ushtritë e sulltanit, para të cilit Evropa e përmbysur tmerrohej sa i dëgjonte emrin...

Që atëherë emri i Arbrit u harrua përgjithmonë dhe ai hov dhe ai gjak, që kishin çuditur jetën me vepra urtësie, mbetën në të errët gjer më sot...»

Kështu mendon Dara vetë, kurse për Balën ai shkruan:

«Bala, ai që bëri këto këngë, ishte një ushtar i madh, prej atyre që bashkë me Gjergj Mirëshpinë krijuan këtë katund ardhur këtu pas vdekjes së Skënderbeut e pasi ra Kruja e me të gjithë Arbri në duart e turqve. Pleqtë e plakat rrëfejnë deri sot (1765) se Bala ishte një plak i gjelbër, «hijerëndë, i pa përzier me njerëzit, që shkoi ditët duke bredhur çukave e maleve dhe i falej Arbrit; disa herë shkonte shpateve duke folur me vete e duke vajtuar shokët e rinisë së tij dhe gjakun e derdhur kot dhe naforisur Atdheut dhe lirisë së tij».

Qëndrimi ideoemocional i poetit del kështu i njëjtë me atë të heroit të poemës, me ndryshimin e vetëm se ndërsa heroi është pjesëmarrës i ngjarjeve dhe i kujton ato pak kohë më vonë, poet i ka njohur këto ngjarje si histori dhe flet për to nga të njëjtat pozita me ato të Balës, shumë kohë më pas. Pra, në themel, kemi identifikasi-



min e poetit me heroin, siç ndodh pothuajse kurdoherë në poezinë romantike. Është kjo arsyeja e parë që vepra, duke qenë e karakterit epik, merr thekse të dukshëm lirikë, aq sa me të drejtë është quajtur poema epiko-lirike apo liriko-heroike. Në leximin e poemës është e domosdoshme të mbahet parasysh që është Bala ai që flet, që tregon dhe që vlerëson ngjarjet duke futur në to shpirtin e vet, sidomos krenarinë për shokët heroikë të rinisë së vet, dhimbjen e thellë për humbjen e tyre dhe dëshpërimin që nuk sheh të përtërihet edhe një herë ajo epike zulummadhe për «nderin dhe për lirinë e Atdheut». Të gjitha këtyre u shtohet ndjenja e mallit të dëshpëruar të mërgimtarit, që e gjejmë në të gjithë poezinë arbëreshe, që nga kënga e vjetër popullore «O e bukura More», deri te vargjet plot frymëzim të Serembes. Lind kështu, mbi bazën epiko-lirike, një nyje shumë e fortë dhe tronditëse tragjike, që arrin kulmin në «Këngën e Beratit». Në këtë nyje shkrihen në një të vetme tragjedia kombëtare, tragjedia e lumturisë personale, që nuk mund të kuptohet pa lirinë e Atdheut dhe fati tragjik i atyre që «turku e la pa mëmëdhe», siç do të shkruante Serembja. Kjo frymë e poemës është refleksi i botës shpirtërore të Balës e të Darës njëkohësisht, ashtu siç bëhet i Balës mendimi i poetit se Shqipëria «edhe e copëtuat dhe e shtypur — me dritë botën do të mbulojë», mendim që e gjejmë të shprehur si në poemë edhe në parathënie. Ky identifikim i poetit me heroin tregimtar duket më qartë në pjesët përshkruese të veprës, ku edhe ndjenjat gjejnë fushë të shfa-

qen më lirisht, kurse në pjesët tregimtare si dhe në krijimet, në të cilat shfaqen më drejtpërdrejt ndjenjat e heroinjve («Kënga e hënëzës», «Kënga e zogës»), prania e heroit tregimtar zbehet dhe, si të thuash, ai veçohet prej poetit.

Nga gjithë sa u tha del se Dara e ka krijuar plakun Balë për të shprehur nëpërmjet tij lidhjet shpirtërore të tij dhe të gjithë arbëreshve të shekullit të nëntëmbëdhjetë me «dheun e të parëve», me «motin e madh» dhe me të ardhmen e Shqipërisë, që do të ishte vazhdimi i «udhës së ndritur» që çelën me heroizma dhe me gjak «bijtë e motit të madh». Për këto arsye vepra nuk mund të kishte karakter thjeshtë epik. Si poemë romantike ajo do të përmbante domosdo edhe elemente të theksuara lirike dhe tragjike, kështu që nuk kemi të bëjmë në këtë rast me ndonjë kufizim të «talentit epik» të poetit po me një karakteristikë tipike të poezisë romantike, të kushtëzuar nga rrethana objektive historike. Në këtë natyrë të dyfishtë të poemës si dhe në mbështetjen e fuqishme të saj në poezi në popullore përmbahet, para së gjithash, origjinaliteti dhe novatorizmi i padiskutueshëm i Gavril Darës, i cili, për këtë arsye, ze një vend krejt të vetin në të gjithë historinë e pasur të poezisë shqiptare.

Kur lexon poemën lind edhe një pyetje tjetër: ku është mbështetur Gavril Dara, që në fillim të veprës i paraqet Nik Petën dhe Pal Golemin si dy kalorës të lirë, bredhës, që kërkojnë fusha beteje dhe lavdi luftarake?





A kemi të bëjmë në këtë rast me një ndikim të thjeshtë të poezisë kalorsiake evropiane apo me diçka tjetër më me rëndësi?

Lind kështu çështja e kohës kur zhvillohen ngjarjet e poemës. Ka të dhëna të mjafta që të pohojnë se ngjarjet që përshkruhen përfshijnë periudhën historike para luftërave të Skënderbeut deri në betejën tragjike të Beratit. Ndryshe s'ka si shpjegohet që Nik Peta, pasi largohet nga Lala, hyn në ushtrinë e Huniadit dhe lufton, siç thotë ai vetë, «*në Nish e Tulovac e në fushat e Vazait*». Pra, trimëritë e para të Nik Petës e Pal Golemit janë të kohëve para Skënderbeut dhe nga ndarja e Nikut me Marën deri te ndeshja me Ballabanin duhet të ketë kaluar shumë kohë dhe jo «*tre vjetët e taksur*». Përligjet kështu shtegtimi i trimave për zulumë luftarake, mirëpo historia jonë kombëtare nuk na jep të dhëna për ekzistencën e ndonjë shtrese fisnikësh që t'u përgjajnë kalorësve evropianë. Po, nga ana tjetër, në poezinë popullore motivi i shtegtimit të trimave nuk është i panjohur dhe, padyshim, këto motive janë më të vjetra se ato të mercenarizmit apo të nizamëve. Kjo gjë nuk mund të mos mbahet parasysh në trajtimin e çështjes. Veç kësaj, poetët dhe patriotët e Rilindjes, për të zgjuar ndërgjegjen kombëtare dhe për të nxitur sedrën e bashkatdhetarëve i dhanë shumë rëndësi motivit të luftës së trimave shqiptarë «*për të tjerët*», të trimërive pa qëllime kombëtare. Edhe nga kjo pikëpamje po ta marrim, sidomos duke mbajtur parasysh tërësinë e poemës, Nik Peta dhe Pal Golemi janë heronj

ë letërsisë së Rilindjes, që mishërojnë fazën e kalig-  
ga trimëria kalorësiake pa qëllime kombëtare në luf-  
ndërgjegjshme për mbrojtjen e Atdheut prej push-  
të huaj. Ky kalim në poemë lihet të nënkuptohet,  
poeti nuk i ka dhënë vend trajtimit të çështjes së ba-  
it të trimave me Skënderbeun, po nuk është e vësh-  
ë mëndohet se ata që kishin luftuar edhe më parë  
r turqve si bashkëluftëtarë të Huniadit, kur Skën-  
u ngriti flamurin e luftës vrapuan të bashkohen me të  
ështu luftërat e trimëritë e tyre morën një përmbajtje  
një kuptim të ri kombëtar, që del madhërisht si-  
s në fjalët që ata thonë para vdekjes. Nga gjithë sa  
del se *pikënisja* dhe *përmbajtja* e bëmave të dy he-  
e në themel të tyre janë shqiptarë dhe të lidhura jo  
donjë ndikim të huaj, po me një problem karakteri-  
ër letërsinë tonë të Rilindjes dhe me traditën e poe-  
opullore, të cilat kanë lënë gjurmë në të gjitha mo-  
t kryesore të romanit të dy të rinjve: ndarja e tyre  
ton poezinë popullore (*po s'u ktheva të tretin vit...*);  
mi i Marës ka përmbajtje historike dhe karakter  
t shqiptar; fundi gjithashtu është plotësisht shqip-  
e shumë i afërt, në mos i njëjtë, me traditën e poezi-  
pullore. Në qoftë se me gjithë këto, ka diçka që të  
n prapë poezinë kalorsiake evropiane, kjo është ve-  
içka formale dhe pa shumë rëndësi, një refleks i lar-  
kulturës letrare të poetit, siç është edhe rasti i për-  
nit të Skënderbeut e të bashkëluftëtarëve të tij, që  
asojnë me përshkrimet homerike.





Subjekti i poemës «Kënga e sprasme e Balës», megjithëse ka karakter linear, është mjaft i hapur, i përbërë nga copa të mëdha ngjarjesh të vendosura në një sfond të gjërë historik dhe të përcaktuara prej tij. Pra nuk kemi të bëjmë me një poemë të mirëfilltë tregimtare në të cilën do të përshkruhej në vazhdimësi e me konsekuencë rruga e jetës së heronjve si një realitet i zgjedhur dhe i përcaktuar nga ata vetë. Përkundrazi, pothuajse në gjithçka (përjashtojmë pjesën e parë të poemës) është e kushtëzuar historikisht dhe vullneti i heronjve gjen shprehje dhe del madhërisht pikërisht se i nënshtrohet një ideali të madh, ngrihet mbi ndjenjat personale, sado të fuqishme që janë ato, kurse rruga që ndjekin heronjtë është ajo e zhvillimit të luftës në përgjithësi dhe e fateve të Atdheut. Ka kështu një konsekuencë logjike dhe historike të fortë në themelet e poemës, megjithëse shpesh mungojnë hollësitë e lidhjeve të jashtme të subjektit. Nuk flitet në poemë ç'rrugë ndoqën heronjtë për të arritur te Skënderbeu ç'ndodhi pas shpëtimit të Marës dhe ç'rrugë morën ngjarjet deri në betejën e përgjithshme të Beratit, që shënon kulmin dhe fundin e heronjve, po lexuesi, megjithë këtë formon bindjen se kjo ishte rruga e vetme e heronjve dhe i plotëson pa vështirësi «zbrazësitë» e subjektit, mbështetur në të dhënat e kursyera, po shumë shprehëse që poeti na jep në formë fare të natyrshme dhe si paqëllim. Le të kujtojmë, për shembull, autoritetin e Skënderbeut, që vetëm me një shikim zbut trimat e hakërryer ose faktin që Nik Peta, për të shpëtuar Marën, kërkon

me lutje lejen e prijësit. Këto dy fakte që mund të duken pa ndonjë rëndësi të madhe dëshmojnë për një shndërrim rrënjësor në konceptet e në qëndrimet e heronjve, të cilët fituan ndjenjën e kombësisë, tani i përulen urdhërit të Atdheut dhe autoritetit të prijësit, kanë fituar ndjenjën e disiplinës e të organizimit dhe kanë lënë prapa kraheve konceptet e dikurshme «aventureske» kalorsiake. Për këto arsye nuk thuhet asgjë për marrëdhëniet e Nikut me Marën pas bashkimit të tyre, bile, as ky bashkim nuk përshkruhet me hollësi. Pas çlirimit të vajzës problemi i dy të rinjve u zgjidh, po nuk ishte zgjidhur çështja e çlirimit të Atdheut, kështu që Niku, i cili dikur pat menduar se nuk janë faj «*të kthjelltat mendime*» kur «*kordha prehet*», kur vjen çasti vendimtar e *ndërron dasmën me luftën, edhe këngët me Valkalin*. Rritja e tij si karakter është plotësisht e bazuar dhe e përligjur, gjë që mund të thuhet edhe për Pal Golemin. Prandaj, megjithëse historisë së dy të rinjve u kushtohet një pjesë e mirë e poemës, tingëllimi kryesor i saj del shumë jashtë këtij idili dhe i jep edhe këtij vetë një përmbajtje më të thellë e më tronditëse. Ndodh edhe këtu e njëjta gjë që është vënë re me të drejtë për poemën «Këngët e Milosaut» të De Radës, sigurisht në përmasa më të mëdha e me raporte origjinale ndërmjet jetës personale të heronjve dhe veprimeve kombëtare të tyre. Ashtu siç sundon në poemë ideja e luftës, ashtu zotëron në fundin e saj tragjedia e Atdheut mbi tragjedinë personale të heronjve, e cila s'është gjë tjetër veçse një pjesë, një shfaqje konkrete e tragjedisë së madhe kombë-



tare; këtu nuk ka fatalizëm, po si në çdo fund tragjik ka shumë dhimbje për betejën e humbur, për heronjtë e vdekur, të cilët jo vetëm me aktin e tyre, po edhe me fjalët që thonë lartësohen si figura të madhërishme, që nuk mbeten së kaluarës, po priren drejt së ardhmes, drejt luftërave të reja dhe lirisë. Jo pa kuptim Niku, para se të vdesë, i thotë Balës: «*Mos më qaj, vëllathi im, — mos më qaj në zulmën time, — në këtë ditë flamurtare, — në këtë ditë të Arbrit tonë*».

Në qoftë se vdes edhe Mara mbi trupin e Nikut, këtu duhet të shihet, krahas ndjekjes së traditës së poezisë popullore, edhe nënvizimi i idesë së lidhjeve të lumturisë personale me lirinë e Atdheut, pa harruar edhe mendimin e Balës e të vetë Darës se ajo kohë e ndritur mori fund bashkë me heronjtë e saj, kurse shqiptarët do ta përtërijnë atë, vetëm po të bashkohen edhe njëherë si dikur dhe të «*mendojnë se besa e tyre do të jetë një: besë e shenjtë e Arbrit*».

Mbështetja në traditën e poezisë popullore duke sheshit edhe në mjetet shprehëse, në krijimin e lidhjeve të subjektit dhe në stilistikën poetike që është përdorur prej Gavril Darës, i cili është një poet asimilues i mrekullueshëm dhe origjinal, që e ka bërë të vetën gjuhën poetike popullore, duke i dhënë asaj një ngjyrë të qartë individuale, aq sa «*Kënga e sprasme e Balës*» është bërë një vepër e pakrahasueshme. Në qoftë se nga pikëpamja e vërtetësisë historike nuk është e vërtetë deklarata se poema

është pjesë e një eposi të vjetër popullor, nga pikëpamja e konceptimit dhe e realizimit ajo të kujton me shumë karakteristika të saj poezinë popullore arbëreshe. Në përgjithësi përshkrimi i personazheve dhe tregimi i ngjarjeve, vizatimi i portreteve dhe pasqyrimi i gjendjeve shpirtërore, dhënia e ambienteve dhe e rrethanave, pikturimi i natyrës etj. — të gjitha këto janë të afërta me format dhe mjetet që janë përdorur në poezinë popullore, ku çdo hollësi të kujton fshatin dhe këngëtarët popullorë, që e kanë krijuar të gjithë arsenalin e artit të tyre poetik me elemente të natyrës që i rrethon dhe të jetës që bëjnë. Si mjete krahasimi dhe figuracioni poetik, si në këngën popullore edhe në poemën e Gavril Darës janë përdorur elementet më të zakonshme, me të cilat ndodhet në kontakt njeriu i thjeshtë i popullit, siç janë dielli dhe hëna, qielli dhe toka, fushat, malet dhe gjerdhet, zogjtë dhe kafshët (sqifteri, ujku, delja), lulet e malit, burbuqet e trandafilat, retë dhe mjegulla, tymi dhe kusia që zien, deti me dallgë dhe shumë elemente të tjera nga më të zakonshmet e më konkretet, të cilat janë përdorur me mjeshtëri për të portretizuar personazhet, për të dhënë gjendjet e tyre shpirtërore e për të përshkruar ngjarjet e rrethanat me një bukuri poetike të thjeshtë e nga më të natyrshmet, në të shumtën e herës me ndihmën e krahasimeve. Kështu gjoksi i Moisi Golemit i ngjan «kuisë kur valon»; Mara është si «*lulja e malit*», kurse ndërmjet armiqve ajo duket «*si një dele ndër ujq*»; Nik Peta i ngjan «sqifterit» etj. Edhe në të menduarit e në të folurën e personazheve sundon figura-



cioni i poezisë popullore («nga rrënjë e dheut të mbledh burbuqe e trandafile»), gjë që e gjejmë edhe në përshkrime si ky: «Nga gjëmimet e lumbardhat — gjithë bota seç gjëmoi: tymi i dyfekëve — gjithë malet mjegullloi, — nga zbardhim i shpatave — gjithë fushatë shkëlqyen, — me gjak të ushtarëve — seç u mbushënë lumenjtë, — nga copat e heshtave — urë bëheshin e stiseshin».

Edhe gjendjet shpirtërore të personazheve, ashtu si në poezinë popullore, ose jepen shpejt me anë të ndonjë hollësie të jashtme shumë shprehëse, ose me ndihmën e ndonjë paralelizmi me natyrën ose me anë të kuvendimit të tyre me ndonjë element të natyrës, siç ndodh me hënën dhe me zogun. Në rastin e fundit për ta lehtësuar sadopak naivitetin e këtij përftyrimi popullor, Dara nuk i paraqet vetë ruese elementët e natyrës. Heronjtë u drejtohen atyre, por ato nuk luajnë ndonjë rol si në legjendat popullore, por qoftë se lëmë mënjanë vetëm zogun, i cili cicërin pikërisht në çastin kur shfaqet Nik Peta majë shkëmbit. Kurse për përshkrimin e gjendjeve shpirtërore do të mjaftonte të kujtoheshin këto dy raste: gjendja shpirtërore e Balës, të cilit i ngjajnë mendimet e veta «si lisat e errët dhe zhurmën e lumit, që çel vija me përrenjtë» dhe gjendja tronditëse e Marës kur ndodhet para Nikut të vrrarë. «Ne u pamë s'ndër sy, — që na u mbytën në lotë; — helmit buza na qep. — Ajo u zverdh e na vështroi — dhe u kthye, e sa për të vdekurin shtrirë përdhe — dha një klithmë edhe ra — përmbi të e ftohtë si borë. — Vamë t'i flisnim, s'u përgjigj — vamë ta preknim, nuk lëvizi, — vamë ta ngrenim e na

vdiq. — Zemra që ish plot me Nikun e saj — rritur gazit,  
dashurisë, — si u godit nga ai helm — nuk e nxuri ndaj  
i plasi.»

Gjithçka në këto raste, si edhe në shumë raste të tjera, është plotësisht në natyrën e poezisë popullore, është burbuqe e trandafile nga rrënjë e këngëve të tokës sonë, sigurisht të rritura e të selitura nga dora e një mjeshtri të talentuar, i cili mbase nuk do ta kishte pasur më të vështirë ta trajtonte lëndën e poemës në forma poetike të huajtura; po në këtë rast ai vetë ka qenë plotësisht i ndërgegjshëm se nuk do t'u jepte bashkatdhetarëve një vepër me vlera aq të mëdha sa ç'është «Kënga e sprasme e Balës».

RAZI BRAHIMI

*Kënga e Sprasme  
e Balës»*

*Trendafil është jeta  
Trendafil është shogëria  
Trendafil më i bukur  
është Dashuria.*

*Dashuria.*



Meqenëse në brendësinë e këtij  
libri' parhë që përherë lenë shumë  
krytime po të edhe unë  
krytimin tim.

Krytim nga

Ledjex Zypaj

Shkolla e Shesme e Përgjith

Asem Zeneli

Gjirokastër

## PARATHËNIE T'ARBËRESHVE

Prindët tanë, qëkur, si ikën nga Arbëria, erdhën e stisën katundin e Palac-Adrianit, në vitin 1482, ruajtën të ndezur në zemër kujtimin e dashurisë për Atdheun e humbur.

Ati birit e biri nipit i rrëfeu punët e shkëlqyera dhe luftërat e ndershme, që u luftuan në kohën e Skënderbeut; se atëherë për herë të parë dhe, ajme, për të fundit, gjithë bujaria, gjithë trimëria e Arbërit, burra e gra, pleq e të rinj, patën një zemër dhe, duke dashur nderin dhe lirinë e tokës që i lindi, ç'donte njëri e donin të gjithë.

Prandaj, nga ai bashkim i shenjtë, lindi fuqia, që për njëzetepesë vjet shkatërroi forcat e turqve dhe përpiu njëra pas tjetrës ushtritë e sulltanit, para të cilit Evropa e përmbysur tmerrohej sa i dëgjonte emrin.

Pastaj, si u shua, vit pas viti, në varrin që e mbuloi, zulma e madhe e të lartit Kastriot, u ftohën edhe shokët e tij, u humbi besimi dhe u shthur nyja e zemrave; u shpërndanë të gjithë andej-këtej dhe zunë të sulen ata ka-



tund më katund, fis më fis e çetë më çetë; e armiku i keq arriti t'u hynte në mes e si ndodheshin të ndarë, të prishur e të grisur, i futi në zgjedhë hekuri dhe i zvarisi të gjithë në çdo fushë lufte të Apoljes (të Lindjes), që të derdhnin për të huajin gjakun e kursyer për vendin e tyre.

Që atëherë emri i Arbërit u harrua për jetë dhe ai vend e ai gjak, që kishin çuditur botën me vepra ushtrie, mbetën në të errët deri tani; po dhëntë zoti dhe shuhet nëma e motshme që prishi gjinden tonë, e cila ka lindur të zotërojë, po të jetë e shtrënguar në bashkimin e mëparshëm krishterë e muhamedanë, katolikë e ortodoksë, duke menduar se janë vetëm të arbëreshë!

Po tani le të kthehem atje tek fillova.

Pas vdekjes së Skënderbeut e pas më se dhjetë vjetë luftash e përrënsh gjaku nga më i kulluari, që ruajtën në Krujë nderin e lirinë e Atdheut, më të mirët dhe më të urtit bujarë, palosën flamurët e, të helmuar, jo të mundur, u shpërndanë ndër të huaj, duke humbur vendin, që të mos ndërronin besën e nderin. Ndër këta të parët, siç numërohen deri sot, ishin prindët e mi: Mërkuri dhe Njanji i Darenjve, gjini të Kastriotit nga ana e Vojsavës, të ëmës së tij, bijës së princit të Mirditës (Filia Principis Tryballorum-Marinus Barletius). Por mbi të gjithë të parët e mi, në të mbledhurin e kujtimeve të motshme dhe të «Këngëve të Pleqërisë» lartësohen gjyshi im, Gavriili i Darenjve dhe ati im, Ndrica... që naforisën<sup>1)</sup> jetën e

---

1) sakrifikuan

tyre për të mbledhur fije-fije zulmën e popullit tonë, që kohë e ashpër nuk e shkeli e nuk e poshtëroi.

Gjyshi im mblodhi për së pari «Këngët e Pleqërisë», të cilat, pas tij, kanë qenë botuar pjesë-pjesë nga peshkopi Krispi, nga Dhimitër Kamarda e nga të tjerë, që kanë kuptuar sa vlen nderi i Arbërit.

Në mes të shkruarave të tij më të fshehura e më të shtrenjta ati im gjeti, pas «Rënkimeve të Nik Petës e Pal Golemit», një tjetër këngë, e cila sipas dorëshkrimit duhej quajtur «Kënga e sprasme e Balës». Ishin disa vargje që i prekën zemrën, se përfshinin një rrëfim të plotë, të arrirë e të përkryer, më të mirë edhe se «Kënga e Konstandinit e Garentinës». Ati im e kuptoi menjëherë se këto vargje ishin disa pjesë të shkëputura, të lidhura mirë a keq ndërmjet tyre. Duke i zgjedhur ai e pa se lipseshin shumë pjesë, pasi dorëshkrimi nuk kishte më tepër se gjashtëdhjetë vargje të pjesës së parë, aq të së dytës e pak më shumë të së tretës. Ai u bë edhe më i drojtur kur pa në fund të fletës këto shënime:

«Bala, ai që shkroi këto vargje, ishte një ushtar i madh, prej atyre që me Gjergj Mirëshpinë ndërtuan këtë katund, të ardhur këtu pas vdekjes së Skënderbeut dhe pasi ra Kruja, e me të gjithë Arbëri, në duart e turkut. Pleqtë e plakat rrëfejnë deri më sot (1765) se Bala ishte një plak i gjelbër<sup>1)</sup> e i ashpër, i papërzier me njerëzit, që kalonte ditët e muajt mbi çukat e malet prej nga i falej

1) i shëndetshëm.



Arbërit. Disa herë në honet e shpateve fliste me vete dhe vajtonte për shokët e rinisë së tij dhe për gjakun e derdhur e të blatur kot për Atdheun e për lirinë e tij.

Herë-herë, kur ashpërohej dimri e malet e fushat zbardhoheshin borës, ai kërrusej në anë të vatrës dhe gëzohej duke u rrëfyer vashave e djemve punët e asaj kohe, që i quante «Moti i Madh». Bala, për të cilin po flas, shihet deri sot i pikturuar te afresku i kishës së shën Mërisë së hireve, përjashta, fytyrë-çelur, hundëpërpjetë, me shapkën e kuqe, me mājën e artë në përkrenare, siç ishte zakoni i ushtarëve tanë.

Im atë, s'deshi tjetër: zu të bredhë lart e poshtë isetur, duke pyetur pleqtë e plakat mos dinin «Këngët e Balës» e, pak këtu e pak atje, mblodhi gojë më gojë më të shumtat pjesë që i mungonin dorëshkrimit të prindërve dhe ua shtoi. Kështu «Kënga e sprasme e Balës» mor formë dhe, do të thoshja, u plotësua në të gjitha pjesët e saj; dhe në qoftë se mungon ndonjë copëz aty-këtu, dëm është i lehtë, se mund t'i plotësojmë me mendjen tonë atë pak zbrazësi.

Unë, që arrita i treti e i sprasmi, në një kohë ku njerëzit e motshëm nuk ishin më në botë, pak gjeta dhe pak i shtova, thujse vetëm «Këngën e zogës» të mësuara që në fëmijëri, pasi sapo lexova «Këngën e Balës» më duk e më duket se është krijuar e përpunuar nga mendja që ka krijuar edhe të tjerat dhe se muhdi të shtohet vetëm në vendin ku e kam futur. Mua më duket se as gjysë as prindi im nuk e patën dëgjuar kurrë, se po ta kish

njohur nuk do të kishin harruar ta shkruanin, siç e shkruan e më lanë, si dhjatë, këngët e tjera.

E pata mësuar «Këngën e zogës» gojës së zonjës Marë të Bidhërenjve, gjyshes së hallës sime, zonjës Maruke të Darenjve, nënës së tim kushëriri Tueit të Darenjve, i cili në këto kohë të errëta, përhapri prapë dritën e Arbërit, shpalosi flamurin e nderit para mbretërive e qeverive dhe bëri të njihet në botë gjithandej, se këtu, afër Italisë, në anën tjetër të detit tonë, rron akoma një popull i urtë dhe i vjetër, i cili thërret e do liri, qeveri të tij dhe vendin që i përket në mes të popujve të tjerë të Evropës. E, siç thashë, zonja Marë e Bidhërenjve ishte ajo që më mësoi «Këngën e zogut».

Ajo ishte një bujareshë e madhe dhe e ndershme dhe, ndonëse plakë, ishte e gjelbër dhe e gjallë. E kam para syve me atë kezë të shkëlqyer ari, me shaminë hedhur prapa qafës, që i binte deri te këmbët, me brezin e mëndafshhtë e të kadifejtë të qendisur me ar, me gjoksin e hapur të shtrënguar me një kordon ari, se edhe plakë rrinë e dimër e verë me krye e me llërë të zbuluar. Brezi i artë ishte derdhur rreth e rreth me konëza sheitash<sup>1)</sup> e në mes, në vend të tokasë, dukej shën Gjergji kaluar kur po qëllonte draguan.

Fustani i të kremteve i vlente sa një thesar, i tjerre me ar e me mëndafsh si sixhade, gjithë tufa-tufa lulësh, sa të merrnin sytë. Edhe kaleat<sup>2)</sup> e saj ishin prej stofi e

1) fytyra shenjtorësh

2) lloj këpucësh



ari të mbërthyer me sumbulla floriri me tirqet e mëndafshta të qëndisura me ar.

Më kujtohet se kur nisej ajo të vinte në kishën e madhe për pashkë a në dasmat e farefisit, me kryet lart e të zbuluar dhe me ato stoli, na dukej një perëndeshë dhe nuk ngopeshim duke e parë deri sa perëndoi. Kjo bujareshë, sa ishte e lartë, e urtë dhe e ditur, aq ishte edhe zemërmirë në vepra dhe e përzemërt me të gjithë... Dora e saj gjithnjë e hapët, fjala e ëmbël dhe e dhemshur lehtësonin, në mos shëronin gjithë helmet. Po ngazëllimi më i madh i saj ishte hareja e fëmijëve (unë po i ndodhesha), kur, pasi na kishte thirrur prej ballkonit, na jepte kuleçë të ëmbël, petulla të lyera me mjaltë, e hera herës na jepte secilit nga një lugë plot me liko të bërë me fletë trëndafili të shtypura në gjalpë dhe të ziera me sheqer, që ajo na thosh se quhej *liko e Arbërit*.

Si ishim ngopur, ulyeshim rreth saj dhe ajo, ose na rrëfente përrallëza të motshme për Skënderbeun e trimat e tij, ose na këndonte e na mësonte «Këngët e Pleqërisë» se i dinte të gjitha përmendësh e, si fillonte, nuk kishte të sosur më. Të tjerat unë si i vogëlth, i harrova; po nuk di si më mbeti në kokë vetëm «Kënga e zogut»; them se më është dukur më e bukur, ndaj e mësova më shpejt e më mirë.

Zonja Marë na rrëfente se këtë këngë e këndonte gjithnjë gjyshja e saj, zonja Martuke e Suljotëve, e eila (kur u martua) meqë nuk gjeti dafinë kishte venë kurorë me kulpër e me urthe, prandaj i nxorën këngën që thotë:

Mos bëni si suljotë,  
që me kulpër e me urthe  
vunë kurorë atij mëngjesi...

Ajo shtoi se Bala nuk kishte bërë vetëm «Këngën e zogut», por edhe shumë të tjera, që zenë fill që kur Skënderbeu, i ikur prej turqve, gënjen me vulën e sulltanit pashanë që ishte në Krujë dhe, luftë pas lufte arrijnë deri te «Dita e Dibrës», kur qenë zënë Moisiu i Golemëve me të shtatë shokët e tij dhe vdiqën Nik Peta e Pal Golemi me katërqind trima në betejën e Valkalit. Bala, siç thoshte ajo, ishte nga familja e Balshëve, që më parë nuk quhehin ashtu, po e morën këtë emër që kur Balsha i parë, afro njëqind vjet para Kastriotëve, mundi turqit në një betejë të madhe dhe u quajt despot i Arbërit dhe pasi e shtriu sundimin e tij në Malin e Zi e në vendet përtej e, nga ana tjetër, arriti deri në Maqedoni, prandaj u quajt «Despot i madh». (Shih Ketën, Dhimitër Kamardën, etj).

Fola shumë për zonjën Marë të Bidhërenjve, se më hoqi puna, po edhe se, si të gjithë pleqtë, unë rroj në kohën e shkuar dhe kaloj ditët duke kujtuar njerëzit dhe zakonet e përmendura. Ajo vdiq në vitin e kolerës 1837 e me të u shua e fundit bujareshë, që ruajti gjithnjë zakonin të vishej si arbëreshat e motshme.

Iu përvësua «Këngës së sprasme të Balës», së pari në vargje italisht fjalë për fjalë, që ta kuptojnë italianët ndërsa arbëreshët e Arbërit, që kanë përzier e trazuar gjuhën me turqit e me gjitonët, të mendojnë se gjaku ynë,



i përhapur në fshatrat arbëreshe të Italisë e ndër të huaj, ka këtu e katërqind vjet jo vetëm këtë gjuhë, po edhe të folurën e kulluar e të stolisur si flitej në kohën e artë të Arbërit, në kohën e Skënderbeut. Se dihet gjithandej, që qytetet e fshatrat, ku venë e mbeten njerëzit e përzënë atdheut të tyre, mbajnë e ruajnë pa përzier gjuhën e sjellë në dhe të huaj e se, ndërsa ajo ndërrohet e trazohet me kohë në tokën amtare, këtej mbetet si ishte në kohë të parë.

Kështu, spanjollët thonë se gjuha e vjetër e Kastiljes flitet më bukur se gjetkë në Meksikë, ku e shpunë Fernando Kortesi e shokët e tij; po kështu vërejmë se gjuha më e mirë e Italisë ndodhet mbi malet e ndër shpatet, afër Pistojsë e Sienës, në kasollet e shpërndara në shkreti, ku rrojnë si të huaj fshatarë e barinj që flasin deri sot si flisnin Dantia dhe Dino Kompanji. Ashtu si përroi i shiut shkul dushqet dhe baltën e fushës dhe nuk nget shkrepat, po ashtu lumi i kohës lë pa ngarë zakonet e të folurën e strukur larg rrëzës së tij. Do të ma donte zemra që «Kënga e Balës» të jetë për arbëreshët (a shqiptarët) ashtu siç qenë për grekët e vjetër këngët e Homerit: dhjata e bashkimit, flaka e lirisë, veriga e dashurisë, për të lidhur gjithë vëllezërit, që flasin në një gjuhë, sa njihen të lerë një gjaku, sa janë prej këmbës së Malit të Zi e në çukat e Mirditës e të Himarës, deri në detin e Artës e të Janinës!

Arbër, mirditorë, gegë, toskë, çamë, himarjotë e sa farë janë të kujtojnë se besa e tyre do të jetë një: besa e

shenjtë e Arbërit! E mos t'u duken të tepruara fjalët e mia, kur vë përballë njëri-tjetrit të errët<sup>1)</sup> Balë me Homerin e ndritur, pikën e ujit me detin, se si njëri edhe tjetri përngjajnë nga dashuria për vendin e tyre, të cilit si njëri edhe tjetri i dhanë zemrën, gjithë gjakun, gjithë jetën...

Bala, si Homeri, na paraqet trimat e bujarët e «Motit të Madh», punët e shkëlqyera të tyre, si pasqyrë ku të shikohen nipat, që të ndizen nga urtësia e nderi, pa shkarë kurrë nga udha e madhe e prindërve.

Unë jam i bindur se po të mos kishin humbur «Këngët e para të Balës», që pat shkruar në rini, në të cilat kishte mbledhur e pikturuar ato lufta titanësh, që ai i përjetoi për shumë kohë, them se Arbëri do të kishte pasur Homerthin e vet.

Por, sado i vogël dhe i zhveshur që të jetë thesari që na ruajtën prindërit tanë, mjafton që të marrim vesh sa të mira na vodhi fati ynë i keq. Ky fat i keq akoma nuk duket i ngopur me helmet e pasosura të Arbërit...

Ashtu si flamujt në luftë mbahen për shenjë të At-dheut, që të mblidhen rreth tij ushtarët e shpërndarë, ashtu edhe këngët, ndër mote, janë drita ku ndizen zemrat e të urtëve, shenja e kombësisë, flamuri i nderit, dhjata e prindërve.

---

1) të panjohurin.



Kujtim nga  
Fabiola Sherifi  
sh: "Sini Shaplo" Gjinokesti

2001

# PJESA E PARË

## I

### BALA

- Mori bijë, bija e Lalës,
- mori e bukur e trishtuar,
- pse më kthen në motnë e shkuar?

Shiko, mjegulla e errët  
rrokulliset mal më mal;  
djellit lerë malit t'Gropës  
tundet, qesh shpati i humbët;  
po, si ti, e bardhë, e kthjellët  
cipëza e qiellit shtrihet  
me një rreth të pasosur,  
e rimtë si ninëza jote.

Edhe zjarrit të pranverës  
çelen gjithë rrahëzat,



edhe tymi hifytyrë  
vete dhe shkrihet me retë,  
posi kënga e meruar<sup>1)</sup>,  
që sjell era për së largu;  
kurse vashëzat pa breza  
të zëna dorë më dorë,  
të thërresinë në valle.

Pa kujdes këmba e djemve  
hidhet rëndë ndër kangjele,  
se kan' zemërën te ti.

O ti lule e hollë malesh,  
o ti e para e vashërisë,  
ec atje ku, te hareja,  
derdhet ari i motit t'parë  
dhe zbavite zemërzën  
n'ëndërr t'ëmbël të mëngjesit!

*palzua kop*

Lerja plakut, lerja Balës  
t'errtët lisa, zhurm'n e lumit  
që, rrëzuar malit t'egër,  
grryen shpatin me përrenjtë  
si mendimi im i shkretë  
më lëndon e përvëlon  
n'ëndërr t'ëmbël të mëngjesit!

---

1) e meruar — e trishtuar.

- Dyzet herë krahu i dimrit  
- ra mbi Honin e mbi Brinjën  
- e i thau e i zbardhoi;  
- dhe aq herë bleruan arat  
- tek ugarëzet e Fushës,  
që kur i mblodh dheu i huaj  
të ikurit, të pafatmit;  
e që ahëre gëzim  
më nuk shkrepni kësaj nate,  
që mbi trutë më është' kumbisur.

- Ndër sy kam e fluturojnë  
- vite, trima e pun' të shkuara,  
- sikur era, që ndrron retë,  
- e përveshur, e zvarisur  
- i përze me frymë e gji.

Koha ecën pa u ndier  
mbi të shkretinë dhënar,  
po mbi ballin e ushtarit  
bien si plumb këto ditë,  
sepse me duar të ftohta  
brenda mu në varr e shtijnë.  
- Këto ditë kotësie  
- të helmëta janë, vashë,  
- posi vdekja për Balën.



Se ky krah, tani i flashkët,  
shumë herë sëllloi ushtën  
ndër ushtarë, e bëmat tona  
shumë herë me lëvdime  
u kënduanë nga vashat.  
Tani q'eci shkretirës  
edhe mbeta gjallë e zi,  
fora e t'rinjve më la  
të harruar në një skaj.

Po veç ti (si rrembë e qiellit  
lehtë e lehtë dimrit t'egër  
zgjon të mjerinë dhënar,  
tretur tek luginë e Llazit  
dhe e gëzon me afsh e dritë)  
përdëllim i brengës sime,  
me mua vjen në errësirë.

Dhe, sakaq, përpara syve  
kam bujarëtë, të fortët,  
të vrenjtur e të helmuar  
si m'u dukën për së largu  
çukat maleve shpërndarë,  
kur nga deti iu përfala  
për së fundi e më s'i pashë!  
— O ju bij të motit t'madh,

- hapët një udhë të ndritur
- në thellësitë e viteve;
- zulma juaj ishte diell
- përmbi botën e përmbysur;
- ajo eshtrat ju shkëlqen,
- posi dielli më t'perënduar,
- gjithë me zjarr e me shkëndijë,
- mbulon valët në trazim.

Po ushtarët s'duan helme,  
s'duan qarë... Por, po deshe,  
emri yt tani më ndezi  
një përrallëzë plot lotë.





## II

### PËRRALLËZA

Derdhi nata tërë mjegullat  
mbi të zezat e luftës;  
u ngrit era e shprishi urët  
mbanë gjumit trimave.  
Trupat e tyre të bëshëm  
përmbi truall ndeheshin,  
ëndërrat venin në luftë.  
Herë-herë këmbërënda  
shponin hijen trumba nate,  
posi xhindërit e çmendur,  
që bredhin Gropës së Dresë  
kur nuk ka as erë as dritë.

Atje ku shtrin lisi i Mbretit  
deg't e gjata, përmbi çukën

e kodrës së Ballëshit,  
lart u ndez zjarri i madh  
darkës së bujarëve  
e u përzie rreth e rreth  
gaz edhe hare nga gotat.  
Flaka e bardhë, shprishur erës,  
rrihte ballët e ushtarve,  
që rrethonin Zotn' e luftës,  
duke u dridhur mbi parzmoret,  
si shkretimt përmbi valë.

Skënderbeu po gëzohej  
me ata trimat vëllezër,  
se në zëmërë i flitite  
forc' e rritur prej atyre  
mbi krahë të shqipes zezë.  
Nd'anë atij e prapa shkëmbit,  
mbi mburojënë mbështetej  
fuqia e moçme e Darës.  
Fara e tij, degë lisi,  
mbledhur, dëgjonte mësimet  
e shumë viteve të shkuar.  
Grunda<sup>1)</sup> e bardhë, fryjtur erës,  
dukej si borë e shpërndarë  
majë Gurmadhit të zhveshur.

---

1) grundë — flokët, leshrat



Tej, te hija e Lisit t'Helmit,  
veç së gjithësh, ballëfshetur  
rrinte i madh' i Golemëve  
me sytë ngjitur në dhe.

E gjoksi leshtor i rrihte,  
si kusia kur valon.

Nga çdo përpjekje qepallash  
derdhej helmi i zemërës.

Se, në zemërë, kujtimi  
i ditës keqe të marrëzisë  
iu fundos si gur në det.  
Si në gjumë ai kujtonte  
ëmbëlsinë e lëvdimeve,  
tek i faleshin katundet,  
kur vinte «Dragoi i Dibrës»  
q'e mbanin të par' të luftës,  
nder t'ushtrisë, mall vashash,  
edhe trim të këngëve...

E tani, të turpëruar  
e vështron nata e shkretë!

Mbreti i urtë na e kuptoi  
vrerë e egër të bujarit  
e i foli dhemshurisht,  
si puhia e mesditës:

O ti, zot i Prroit t'Shtogut,  
o ushtar i moçmë i Llazit,  
i pari i Darenjëve,  
krahu yt dukej si zjarr  
që shpatin e përcëllon;  
ballë teje gjithë armiqtë  
qenë mjegull që kalon.  
N'ato ditë shumë ushtri,  
shumë lufta e trima u panë,  
që kjo kohë nuk i sheh...  
Ajme! ~~Fara e tyre u shua,~~  
~~qeni i mudi, përdhe ranë:~~  
~~flamur, kordhë e trimëri.~~  
Nata e helmët të mbuloftë  
ditë vdekje, ditë dhune,  
gjithë të shtunatë ardhçin,  
e Shalës mos ardh të kurrë!  
Të përzëntë edhe moti,  
ditë e zezë, e pisëruar!

poesia po

Po, çna qe?... Një zë kumboi  
mbi kët' mal e u ndje gjëmimi,  
që prej reve i shkëputur,  
rrëzon erë e dredhë gjëmë  
dhe të urtët m'u ngrenë,  
lajtën dhunënë me gjak,  
zulma e mirë prap u ndez.



Thuaju, i dijshtëm, djemave,  
se fëjesa<sup>1)</sup> e të mirëve  
lahet me bëma të ndershme,  
posi guri i paçmuar.  
Të lartë ishin e ashtu janë,  
kthyer në udh' të dritës tyre,  
e andaj ngrihen mbi prindët,  
posi bora e Sharrit tënë  
përmbi rrahët e përposhtme».   
Mbreti heshti; ai turbulluar  
humbi t'errtit: i pashpresë,  
mendja te vdekja i vate...

. . . . .

(Këtu mungon një pjesë)

---

1) fëjesë — faj

### III

#### KËNGA E HËNËZËS

*Vetë dregtimin i Nikut  
tek hënësia  
(Biseda e tij)*

Me notinë e puhizës  
erdh një zëth asaj nate  
i helmuar, i paçquar,  
si pshertimë e vashës s're,  
kur ia fryn malli i parë  
gjinë e njomë e ajo s'e di.

O ti, më qofsh i bekuar,  
zot i këngëve të hijshme,  
vlastari i lartë i Petës!  
Zërin tënd s'e ka njeri...  
Kur do Niku derdhen lotë,  
po të dojë ndizet fora<sup>1)</sup>.

---

1) Ndizen hove.



Pa piptitur, të magjepsur  
vamë tek kënga na çoi:  
Ai qe ulur përmbi gurin,  
përmbi gurin e përroit  
e një rreze hënëze,  
depërtuar nëpër re,  
i pështill grundën e verdhë  
me kurorëzën e qiellit.  
Dukej ëndërrëz e mirë,  
tek po bredh lule më lule  
e rrjedh lehtë valëve  
dhe me erënë këndon,  
pastaj vete e fluturon  
si një yllëth i këputur. *poeto pep*  
Kënga e tij vente larg,  
larg e tek e bukura,  
e përmallshme, më të qarë:

*pep*  
— Ec, hënëzo, vrapo,  
nëpër kaltërsit' pasosje!  
Këtu s'është liqen' i argjendtë,  
dhe as deti si pasqyrë,  
ku ti shihe e zbukurohe,  
kur i dashuri, i zjarri  
të pushton në shtratnë e thellë;  
këtu sheh lisa e shkëmbenj,  
ikën koha e ai të pret!

Udha jote është e gjatë;  
ec, vrapo, e bardha bijë!..  
Pse u stepe? . . . Ç'droje ke?  
Mos vall' mjegullat e zeza  
të ndërpliksen nëpër këmbë  
e ti trembe, mos e shuar  
frymës krahëve të ftohtë,  
mbetet nata si e ve?

Mos si imja është zemra jote,  
dritë e hijshme, e pahare,  
që brymën e syve derdh  
e kërrusurë në hije?  
Edhe n'ato shtëpi të ndritme  
arritka kjo zi e shkretë?  
Por ti qesh!... Hënëzo, priru,  
dëgjomë, moj, nga qerrja jote!  
Kur të t'bjerë syri i lumë  
përmbi krojet e mermertë  
dhe të ndiesh erë lulesh,  
mos më ik, o zonjë e natës,  
po më derdh dritën e butë!  
Do t'shohësh atje, ballë teje,  
bijn' e rrallë të Kaurit,  
zogn' e Lalës gërshetprishur,  
gjirin e bardhë si vala  
e nga helmi sytë tretur.



5855/4

Fier

Përzën gazin edhe diellin,  
vetëm netëve, në shpat,  
me ty qan e kuvëndon,  
dhe, kur soset drita jote  
atje larg e përmbi det,  
të përcjell me psherëtima  
e në shtratëth të mbëllin<sup>1)</sup>.  
Ditën sillet fillja vetëm  
nëpër kullëzën e shkretë,  
pa longar edhe pa fyell.  
Që me natë hidhen, kërcejnë  
qent' e saja hundëfryrë,  
veshëngritur... Porse hesht  
Gropa e Dhelprës; se në gjah  
e bukura nuk duket më  
duke ndjekurë kaprojtë.  
Drerët venë edhe bredhin;  
nëpër madërgona<sup>2)</sup> kopshtit  
lulet vyshken pakujdesit.  
Mendja e saja endet larg,  
se asnjëri ndër gjahtar'  
nuk ia kënaq dot syrin.  
Jashtë shpellave të kohës  
nxori kryet ditë e pritur,

1) mbëllinj — mbyll.

2) madërgonë — bar i trashë, driza

P.P. }  
po prap zbrazësisë u shua;  
n'erë lufte e pështjellë  
kohë e pritur po mënon!

Ec, hënëzo, vrapo,  
që me rreze ta pushtosh,  
para se nata të soset.

Ai u qet e Dara i tha  
një të thënë të diturish:

P.P. }  
— Erëza përkul kallinjtë  
duke prehur korrësit,  
e ti, biri i Lisanës,  
gëzon natëzën me këngë.  
Të zjen zemra e buron  
si rrjedhë uji të kthjelluar;  
ti për kordhë në ushtri  
dhe për këngë je i shquar!  
Po përgjigjmu, djalë i Petës:  
malli yt s'ka rënë në pleh?  
Hiri i vashëzës së huaj  
a s'është si farmak që mbyt?  
U përmbysënë Kaurët  
bashk' me kullat e prindve  
e u qëlloi gjumë i gjatë,



në një natë që s'ka fund.  
Gjaku i tyre u turbullua  
si përrua larg nga kroi,  
porsi re pa shkrepëtimë.  
Ajo ikonë mbirë me lulet,  
është rritur me pekule  
që burojnë të qelburish...  
Fara jote si të shkojë,  
si të shkojë e të shkëlqejë  
në atë gjak të trazuar?  
Cipa e nderit i pështjell  
gratë tona dhe nderi i mban,  
nuk duan fushat me lule,  
as puhizënë e hollë,  
po i gzohen dimërit;  
droja e shpatit u pëlqen,  
edhe deti se gjëmon;  
dasmë luftat janë për to —  
andaj edhe lindin trima.  
Bisk' i Petës, këtej priru  
e nga rrënja e dheut tënd  
mblidh burbuqe e trëndafila,  
se s'ka gjetkë kaq erëmirë...  
Pse të zuri zekth' i huaj?  
Teksa bota errësohet  
harro kezën<sup>1)</sup>... Të merr sytë

---

1) kezë — kësulë kadifeje qëndisur me ar.

zbardhëllimi i shpatave.

Iu gjegj Niku gojëmbël  
edhe i tha:

— Shumë herë  
vajta n'ushtri, shumë herë  
shkela këmbët e t'ikurve:  
dita e djersur e nderit  
ka ndritur mbi ushtën time;  
po prej lëvdatash u mbrojta.  
Te ky gji thërret një zë,  
zë i fortë; vetë e ndjej,  
mos për vrasje, vall', gjithnjë  
rrahka zemra? Dhe, n'e nginjur  
prehet kordha, mos është faj  
mendimi i pastër, vallë?

{ Unë, e them, dua një vashë,  
vashë të mirë, të ndershme,  
që është' flakë e nuk më shuan;  
ja, dëgjo se si më ndez.



10  
Lulja e  
Krytimitor.



Lulja e korrimit



Edhe syshkan

#### IV

### VASHA E LALËS

Mblodhi krahët e pushoi  
mbi të mundurit shqiponja;  
varur ledhit rrinin kordhat,  
era tundëte mburojat.  
Unë — djalë edhe i pashquar,  
ndjeja trimat e lëvdimet,  
i mërzhitur ndanë vatrës.  
Një mëngjesi, ndër të tjerët,  
vura udhën nën këmbë,  
për të gjetur zulm a varr.  
Pas gjasht' ditësh pashë djellin,  
që po u falej nga deti  
maleve të Lalërisë,  
duke ua skuqur pirqjet.  
Udha futej nëpër gryka,  
nëpër brinja e gremina

e unë ecja duke shkelur  
fletët vyshkur nga thëllimi.  
I rrëzuar, një kaproll  
ngrinte kryet mbi fjerishte,  
pra kërcente shkëmb mbi shkëmb.  
Atëhere, që nga prapa,  
më cënoi një tringëllim,  
tringëllim e hekurit.

Unë u ktheva o ta vërvitja  
o ta pritja... Aty u duk  
bisht' i përkrenares s'Arbrit  
dhe unë njoha Pal Golemin,  
Golemin e Vogëlith  
buzëfrytur, gjoksçeliku.

Edhe ai vente për nder  
e, me mua si u poq,  
ecëm bashkë më guximtarë.  
Si arritëm përmbi çukat,  
u hap udha nëpër lisa,  
ku rrëkezatë ujisin  
ato lulëzat e huaja.  
Aty pamë ulur burbuqen,  
burbuqëzën e Lalës  
me gjithë vashat e saj.  
Si na pa, u qas e u skuq,  
duke thënë:

— Pse armatosur,  
armatosur ju te Lulja?



Zbardhëllimi i kordhave,  
më mirë përballë armikut,  
se ndër vashëza, shkëlqeftë...  
Këtu nuk gjeni hajdhi<sup>1)</sup>,  
jemi vetëmëz, pa burrat,  
se na vanë tek qeni i lig  
na shkel eshtërat e prindve...

*meso popullore*

— Po këtu tryeza s'shtrohet  
për të huaj e bujtarë?

— Eni, hyni: mirë se vjen  
kush na vjen mik në shtëpi!

Iu përgjegja: — As ndër lulet,  
as ndër vasha, e bukur zonjë,  
kordha e Arbrit zbardhëllon;  
gjetkë edhe do shkëlqejë...  
As nuk erdhëm për të ngrënë.  
Sa të zbardhëllojë agimi,  
nga shenjat e plagëve  
do të na njohin laljotët,  
do na njohë qenëria.

1) hajdhi — gëzim, përkëdhelje

U err nata. Syt' e mi  
u mbërthyen m'atë vashë;  
gjiri im u bë si valë  
e trazuar në bregdet.  
Më të nesërmen na gjeti  
dritë e parë në ushtri.  
Të pabesëtë na nxuarr'  
përballë diellit mburojat,  
njëqind bishta e pashallarë.  
Iu vërvitëm si dy dema;  
ca i shkelëm e ca ikën;  
lart u ngrit zulma jonë.  
Dy të huajtë ndër valle  
e në këngë u kënduan.  
Unë ndjeva psherëtima  
ndër fytyra e brenda syve.  
Dhe iu pruar mallit tim  
vasha e Lalës e më qeshi,  
siç gëzon yllëthi i verës *Malis Pop*  
qiell e re me drit' të bardhë...  
M'u hap zemra e m'u ngroh gjaku.  
Guna e natës i mbuloi  
shpirt' e darkën e Kaurit;  
ranë burijat edhe fyejt,  
gazi, gotat u përzien.  
Kish për krahu zot' i vrerët  
syt' e rimitë të së bijës:  
në faqezat posi shtalpë



ndrinte zemëra e butë,  
me një hije e një hare,  
që krejt kurmin ma pushtoi.

Ndonëse qeshej, Kauri  
ishte re plot shkrepëtimë,  
që vret njerëzit pa gjëmë.  
I shpëtoi mendimi i keq  
posi thikë shpëtuar millit.  
Ballë tryezës u ul Frika.

Pa u ngrita e mora i thashë:  
— Haptë mjegullat emri yt,  
aq i tmerrshëm përmbi fushat  
e mbi bretkosat e llucës  
lart, si qifti, fluturoftë!  
Ty t'u rritshin dhën e lopë,  
zot i shpateve të zeza...  
Dhe mos ardhtë ajo kohë  
që t'përpijë kullat e Lalës,  
visar, emër, pìrgje, farë,  
sikurse rrëmben përroi  
xunkthe dhe barishte rrëzës!  
Kur të t'zbardhet ata ballë,  
asnjë birth me faqet mollë,  
ardhur të të përtërijë,

s'do të t'ulet përmbi gjunjë;  
e këputur do bjerë ushta,  
pa një dorë që ta ngrerë,  
as flamuri yt në luftë,  
as varri s'do të të njihen!  
Përse nuk të mbiu një lis?  
Në hijen e degës tënde  
vetëm burbuqeza leu,  
të rritë trima për pemë...  
Ajo digjet e vetmuar,  
si kandili në një shpellë  
e kthjellon e përgëzon  
si lëvdata ushtëtarin,  
që pranë flamurit vdes...  
Eh! Mos u dashka të shuhet  
e të tretet posi yll  
pa një vijëzë në qiell?...  
Ti i pe në kordhën time  
vijat; edhe gjaku i Petës  
është si ari i kulluar....

Sa nuk plasi Pali i nxehur  
e më thirri: — Ç'është, o Petë,  
ajo kordhëz e lëvdimet  
ballë meje, i mjeri djalë?  
Mburre gjetkë gjakun tënd,  
jo tek unë, që i pari



atë thikëzë ta ngjesha!  
Prindt' e mi vanë me mbretër,  
e ti, zot në dy zallishte,  
a nuk strukesh në një shpellë?  
Të marrtë djalli!... Ikonza e Lalës  
me gjith' lulet më përket;  
ndo, po deshe, ja kjo kordhë  
mall e krye do të t'qethë!

Pa mbaruar, unë kërceva  
hoqa kordhën... Por Kauri  
na qërtoi me grahm' të madhe  
e na mbajti:

— Shpejt, në truall,  
forë e kordhë! Të verbuar!  
Ndryshe në hare do t'bjerë  
bubullima e gjaku i derdhur  
do t'më lajë tryezë e darkë...  
Lufta — e madhe e shpresa — e lartë!  
Kurse ju më dashki keçen,  
dritën e vetme të plakut,  
që perandor e mbretëri  
s'e vështruan dot pa drojë!  
O ju t'urtë e farë e shquar,  
lermëni që të zgjedh njërin  
kësaj nate plot këshilla...  
S'do mend, unë, i sprasmi i fisit,

dua ta shoh të bleruar  
mes dy krojeve të rinj  
e me lule tufë-tufë!  
Tani gjumi ju qetoftë;  
nesër, pra, ka për t'u dukur  
kujt i përket nderi i Lalës.

Kur po fliste u shëmtua,  
sytë iu mbytën në gjak;  
gazi u sos e drita u shua.

— Ç'do të jetë? ... Pse me mjaltë  
ishte farmaku përzier?  
Ç'qe ai hidhërim e vrer?  
Po ç'bluaj? Si nuk kam turp?  
Ardhtë ferri, do pushoj!

Më zu gjumi, si n'shtëpi,  
me një ëndërrëz të bardhë,  
që ma ndolli zulma e malli.  
Ishte, them se, mesi natës  
e nga qerpikët e rënda  
ja, një dritë më cënoi  
si një yllëth nëpër re.  
Flokëprishur përmbi zverk,



e pështjellë shqepit<sup>1)</sup> t'hollë,  
si ajo mjegull e butë  
e trazuar përmbi borë,  
që e hijshme llamburin  
porsi Mirëza e hënës,  
që vë rrezetë kurore,  
m'u duk e bukura mua.

I hutuar unë, me gjunjë,  
po e vreja e ajo tha:

— Eja, ngreu, bir i gjumit,  
i sert' edhe i pabindur!  
A s'e sheh atë kufomë,  
që po zgjat duart nga retë  
dhe uluron në të zbrazët  
e të kërkon nga Kauri?  
Kot ti kordhën e rrëmben,  
se këta ushtarë grabitës  
me ç' harqe të padukshëm  
janë luftëtarë tinzarë...  
Edhe të vrasin pa nder,  
kur zotit të zemëruar

---

1) shqep — napë e hollë, vello

në të kuq i ngjyhet shpirti...  
Shoku yt është liruar...  
Eja! Qetu! Dhemshuria  
fajin tënd ma ka shlyer.

Shkoi përpara dhe çdo derë  
me një fjalëzë i hapej,  
se të gjithë rojet e natës  
e njohën edhe u kthyen,  
si t'pauhdët, të friksuar,  
kur ndjejnë këngën q'i nëm.  
Dolëm e yjet m'u zbuluan,  
erë flokët m'i trazoi,  
unë, si miqëve, iu fala.

Faqeskuqur, posi nuse,  
largët hëna perëndoi  
e në bebezën e vashës  
me një dritëzë shkëlqeu.  
Fjala i mbytej në grykë  
e përpiturë në gji,  
veçse shkuli një pshertimë,  
një pshertimë e një rënkim:

— Edhe ti, ruaza e natës,  
edhe ti në çastnë e shkretë



më le vetëm në të keq?  
Me t'u shuar drita jote  
erret qielli e nxihet bota,  
si vjen zija pas gëzimit.  
Po ti m'u kthefsh nëpër sheshe  
e drita jote e dhemshuruar  
zbardhëlloft' dhe këto lotë.  
Udhëtari i pandijshëm  
si erdh, ikën e më s'kthen,  
pa menduar se ku vete,  
se ç'u shua e ç'u plagos,  
se ç'gjak ka në atë pleh,  
që ka shkelurë me këmbë!..  
Ec, o i huaj, pa drojtje,  
gjersa nata të mbulon;  
ec e rrofsh shumë e i lumë,  
i lëvduarë në botë,  
i shkëlqyerë në gjak...  
Në të ardhhtë ndonjë ditë  
m'e helmuarë në jetë  
se kët' herë, mos harrofsh  
edhe Marën e kujtofsh!  
Ndo i gëzuar në shtëpi  
e me shoqëzën në gji,  
duke parë këtë kandil,  
këtëj detit se si humb,  
do të thuash ti me vete:  
«Ashtu hëna, perëndoi

e te Lulja nata u mbyll,  
kur një vashë më liroi...  
Ish e vetme, e trishtuar  
e m'u fal mbytur në lotë;  
tani, them, se do t'jet' kalbur  
si një pemëzë e krimbur».   
K'shtu do t'thuash, duke qarë  
kryezezën, që u dogj  
si një urë ndënë hi...

Tha e u drodh. Unë iu përgjegja:

— Ndo me zemërën e thyer,  
pa dëgjo, e bardha vashë!  
Aq sa moti më duroftë,  
ti do të më jesh uratë,  
dielli dheun e pastron,  
kurse ti jetën gëzon,  
se të dua për në zi,  
se të dua për hare...  
Qoftë në kohë frikësimi,  
qoftë i lënë nga dora e fora,  
n'ëmbëlsinë e dritës sate  
më buroftë fryma e jeta!  
Nderi im për ty do rritet,  
nderi im e nderi yt



përmbi vdekjen e moi kohën!  
Dhe mba mend: po mos rrëmbehet  
zemra jote e fluturon  
afër shtretërish të ndyrë  
perandorësh edhe mbretërish,  
por e butëz do t'i mbahet  
besës sime të panjollë,  
sa t'kalojë i treti vit,  
i magjepsur dritës sime,  
prindi i errët na bekoftë;  
po s'ktheva të tretin vit,  
të tretin, të taksurin,  
vashë, dheu më ka ngrënë!

Si më gjegji, u ngjat e u ntrash,  
ndehti dorën e nata e mblodh;  
keq i shqyer ndër dy helme,  
fitoi zulma e vrap u ktheva  
tek ish i ndritmi Huniad,  
krahëhekuri i tmerrshëm.  
Emri tij ishte gjëmë,  
gjëxim malesh përmbi qentë;  
ai më njohu e i pëlqeu  
zbardhëllim i kësaj kordhe,  
kur në Nish e Tulovac  
e në fushat e Vazait  
qethja krerë si barishtat.

Tani, zërit t'atërisë  
renda, erdha e këtu luftoj  
e sa të shtillet në ajër  
flamur' i Arbrit mbi kodra  
e në vesh do t'më arrijë  
hingëllim e kuajve t'huaj,  
ti, o prijs luftash të moçme,  
të vendosur do t'më gjesh;  
se, ta them, kjo flaka ime  
lart u ndez e lart u ngrit  
ndër dhuntarë të panjohur.  
Dhe, kur kënga e kthjelluar  
do t'gëzojë sheshe e male,  
unë do kthehem tek më pret...  
kur i prehurë ushtari  
do të kthejë në pun't e shkuara.

— Më kot pret, për t'gjallët tim, —  
thirri Pali e natën grisi,  
— Ushtar vallesh edhe këngësh,  
mburacak dhe endacak! =  
Këtu s'vlen fjala e ëmbël  
as dhe floku i lëmuar,  
këtu vetëm kordha vlen,  
po s'u vrave kësaj dore,  
luftëtari flokëdredhur!

---



Hoqën kordhat, të kërcyer  
dhe të sulur, qenë një:  
hekurat u bënë copra  
e çeliku u bë shkëndijë,  
dhe, tash vdekja ndër vëllezër  
mbi të dy majat rënkoï...

Po, çfar' ndodhi? Kush i prapsi,  
dehur vrerit, ndezur gjakut?  
Ato vetulla t'egërsuara  
pse u ulën aq me turp?  
Mbreti u duk, i vështroi  
dhe, pa folë, ku desh i pru.  
Ata ikën si qen' i rrahur,  
përzënë shkopit të dhënarit,  
duke hequr bishtin zvarë.  
Gjithë vanë andej-këndeje.  
Nata u qet dhe shoi urët.

.....

(Mungon një pjesë)

## P J E S A E D Y T Ë

### PLAKU

Hoqi mjegulla në vrap,  
grisur prej erës, stolinë:  
zëri shpellave rënkoj  
larg shpateve të Borës.  
Atë mbrëmje pa një yll,  
si desh Mbreti, duke zgjuar  
rojet e natës, kaloja  
i vetëm, i qet', çap gjatë.  
Ata ndjenë, e rrah' më rrahë  
zogu i zi na frëshkulloi,  
andaj i qetë u ktheva  
në atë Valkal të shkretë,  
ku shkëmbenjtë e rrokullisur  
u gatojnë udhën armiqve  
po të qasen befasisht.  
Atje në majë u mbështeta:  
nën këmbë kisha përruan,  
që vërvitej në një hon  
e mbi krye, të përzjera,  
kisha retë që dridheshin.



Diša herë Vallza më shkundi  
krahët e qelbura ballit  
dhe, në dritë të shkrepëtimës,  
si një kërr m'u dëgjua.  
Bënin dasmë atë natë  
e unë, them se, u trazova  
darkën e keqe e gëzimin.  
Më kanosën e, rreth e rrotull,  
me sytë ndezurë si urë,  
më vështronin e më shanin...  
Llërët desha të kafshoja  
dhe u sula; që nga prapa  
ato vollën, më verbuan  
me një mjegull erëqelbur,  
që të m'hidhnin në greminë;  
un' shpëtova e të nëmurat  
van' e u drodhën posi boshte.

Pastaj qielli u kthjellua,  
veçse ulëtë rënkoj  
era e vidhave e përroi.  
Mendtë e mia n'errësirë  
zbjerrë<sup>1)</sup> ishin si rreze hëne,  
kur prej avullit mufatur  
vete dhe shuhet në hije.

*maryne*

---

1) zbjerrë — humbur

Unë hahesha me veten,  
që më shkonin ditë e vjete  
pa u kuptuar në jetë,  
pa i përdorur në luftë;  
kënga e vashave harron  
djalin e lënë mënjanë,  
vallet sillen dhe e qeshin...  
Puna e natës veç i mbetet,  
që të zihetë me hijet,  
i panjohur dhe pa nder!

Kështu hahesha me veten,  
kur një e krisur më zgjoi.  
— Të jetë era n'ato dushqë,  
apo hieja që bredh?  
Po këtu s'qaset as ujku,  
që i ngopur diku futet  
dhe as dreri frikaman,  
që i shqetësuar kërcen...  
Mos në t'errët janë futur  
pararendsit e armiqve,  
që ditën e kanë frikë?  
Jo, kurrë jo, për ushtën time,  
në terr s'do t'bjer' Arbëria,  
se dhe grisur dhe e shtypur  
do t'mbuloj' botën me dritë!



Ashtu si natën kuçedrat  
kthehen stihis' së Himarës  
e vërviten duke shtënë  
shi me breshër e gjëmime,  
dhe ajo ngrihet i qëllon  
me shkretimë e bubullima  
e, sado sosur, mbërthyer,  
fryma i lipset dhe fuqia.  
Me sytë keq zgurdulluar  
e pëlçet malin me këmbë,  
e derdh zjarrin posi lumë  
dhe, e ndezur, e shkënditur,  
bie përpirë në pisë.

Mora ushtën edhe zbrita  
udhës së shtrembër, në gropë,  
dhe te krekëza<sup>1)</sup> e krrusur  
mbeta, prita e mbajta vesh;  
mbajta vesh e një të ecur  
ndjeva e pashë një si hije  
fort të frikshme, të tërbuar  
sa edhe udhëza s'e nxente.  
Kishte kryetë te retë,  
kishte lumin ndënë këmbë

---

1) krekë — dru i gjinisë së panjave

dhe krejt pyllin errësoi,  
si mjegull e zezë në shkëmb.  
Unë s'u tremba, po e humba;  
gjaku gjithë m'u trazua,  
prej kujtimit m'u rënd nata...  
Mundur prej turpit kërceva  
e drejt udhës hodha ushtën:  
guri i rrahurë kërciti,  
shtiu shkëndija e qielli ndriti  
dhe në tokë, hequr branë,  
ja, më del një plakërush:

— O ti, i ligu ushtar i natës,  
që pa vënë re më hidhesh  
mbi të vetmin udhëtar,  
mbaje kordhën edhe fale  
këtë të moçëmin rob!  
Jet' e rëndë më lakoi  
duar, shpatulla e krahë,  
m'u hap varri në vetveten  
e pa nder do m'kishe vrarë...  
As armik nuk do më kesh,  
se këtu në tru më mbyllet  
fjalë e fshehtë e mbretërisë;  
se mjaft herë kralë e mbretër  
qasën të mjerin Harun,  
si shpatësh të mi luani



pason dhelpërën e zgjuar.  
Natë e thellë është' kohë e shkuar,  
sapo humbet pleqëria;  
plaku, i vetëm, ndonjëherë  
heq andej një fije drite  
e të nesërmen ia shpie:  
e atje larg, atje përposh  
një zhurmë e keqe u ndie;  
ikën bishatë prej frikës  
dhe, e zgjidhur bubullimës,  
rrodhi era gjerë e gjatë.  
Po ti shpjerëmë te Mbreti,  
se errësira ka veshë  
dhe më mirë fjala ruhet  
në të mbyllurën shatore,  
sa livadhit gënjeshtar.

Tha edhe i shpejt' u ngrit,  
si njeri që di se ç'sjell  
e drejt udhën më dëftoi.  
Ca i zbutur nga dyshimi,  
ca i prekur prej mëshirës,  
nga fjalët ca i habitur  
përballë Mbretit u ndodha.

Në një tend' të lartë, të gjerë  
rrinte e mbledhur bujaria,

tek po matej mençuria,  
rrezik, punë, droja e luftës.  
Ishte Gropa e Strezi i vrenjtur  
e me ta bujari i Sulit,  
Shpata trim, i njohur këngës  
të vashëzës mbretëreshë,  
që ia morën me përdhunë  
e ai dhunën me gjak lau.  
Manezi mbi kordhë pështetej,  
burrë bëmash e jo fjalësh.  
Mbi një lëkurë ariu  
rrinte Lleshi flokëzi  
me Muzakën krah për krah  
e me trim'n e Enkelinës,  
Kuqi, Berrëzi e Përlati,  
zoti i madh i Zendës s'madhe  
gjykonin shtruar me ta.  
Arianiti, këshillmiri  
afër mbretit në një fron,  
fjalë të urta hidhte në mes, —  
dritë të fortë në errësirë.  
Atje Hamzai, i mjegulluar  
gryhej vrecit; po ta shihje  
ish si shkëmb rrufes qëlluar.  
Lerë me shpres' mbretërimi  
e qorroi shpresë e verbër  
e në udhë të shtrembër shkoi.  
Por arriti dita e keqe,



me të huajin e piksi,  
që nder edhe nam i hoqi.  
Po kush ish ai zot i madh,  
ballëllartë, që me shpatull  
ngrihej sipër bujarisë,  
si maj' shkëmbi mbi kodrinë?  
Nën të kuqenë mallotë<sup>1)</sup>  
i shkëlqen mburojë e artë...  
Ish i urti Vrana Kont,  
Vranai zemër e krah' lisi,  
që, sa flet, e njëqind fise  
ia nisin këngës së luftës,  
njëqind flamuj shtjell era,  
një mijë kordha lenë millin.  
I lëmonte lesht' langoit  
Mirëshpia pa kujdes,  
se në sy i gjelbëronin  
kodrat e Janinës s'tij.

Rinë, liqeni të shtrihet —  
shesh i rimtë, i kthjelluar,  
por, jo, valëza e rrahur,  
që të shprishet nëpër këmbë,  
nuk zbardhon sa gjiri yt,

---

1) mallotë — mantel i leshtë

*Kënga  
e Arbrit  
Bulet.*

që shtyn linjën e qëndisur,  
q'i ngjan mjegullës së hollë,  
ndërmjet dy kodrash me borë.  
Gjirit, frytur psherëtimash,  
Rinë, të shpëtojn' rënkimet;  
era i merr e ia sjell zotit,  
zotit tënd, që i dëgjon  
e sytë e njomur me lotë  
fshin me dorë e kot i fsheh!  
Por, ç'po them e ç'po kujtoj?  
Trimat e Arbrit gjer më një  
këshill bënin asaj nate,  
që ndër ta i huaji hyri.  
Për së pari i habitur  
rreth vështroi ata të lartë,  
e i magjepsur uli sytë;  
pastaj, duart kryq në gji,  
ndër këmbë Mbretit i ra.

*Monika  
TIRAMO  
Arbrit*

— Mbret i trimave, — i tha, —  
tek shkon ti, atje shkon tmërri,  
nga kthen ti, bëhenë pluhur  
gjith' kopetë e armikut tënd.  
S'ka si ti...

Një britmë e tmërrtë  
bubulloi qytetit t'shenjtë  
e rrodhi në shkretëtirë



bashkë me erën që i ngrinte  
male rëre përmbi mal  
udhëtarit t'përcëlluar.  
Atje, të vetëm në shpellë,  
më gjet britma e më tronditi  
rrëzuar gjumit të humbur,  
duke thirrur: «Zgjohu, ngrehu,  
sill në botë zjarrin tim!

Fara e nëmur e Osmanit  
gënjeu besën që i dhashë  
majë malit të Rustanit,  
se me gjakun e kulluar  
përzjen gjakun e trazuar...  
Qoftë i shkelur përgjithmonë!  
Gjuha jote u bëftë kordhë!»  
Flokët m'u bënë si driza,  
e i ndezur fjalës rëndë  
unë u vështa e u mbatha,  
udhës së helmit u nisa.  
Shumë qava dhe durova,  
gjersa një ditë e zezë  
afër Mokreut më gjet...

— Çfarë gjete? — Mbreti i tha  
buzëgaz plot shkarëzim.<sup>1)</sup> —

---

1) shkarëzim — mospërfillje

Folna pak e folna drejt!  
Pe gjë tradhtarin e poshtër?  
Ku kullotet Ballabani,  
kryekusar ndër kusarë?  
Sa vetë janë? Ç'qëllim kanë?  
Ruaju rrenës! Mos kujtofsha  
që ti vjen të më gënjesh!

Duke u dredhur si purteka,  
si mbet pa folur një çast,  
plaku i zverdhur u përgjegj:

— Përtej maleve një fushë  
ngushtë shtrihet; lumi e ndan,  
an't e humbta lidh një urë;  
afër urës, në një kodër  
me murriza dhe me gjeshtër,  
kulpër, ferra e kulumbri,  
tre mij' harqe janë fshehur.  
Prapa kodrës, në një shesh,  
plot livadhet janë mbushur.  
Kuajt janë milingonë,  
nuk ka kalë pa kalorës.  
Me këto rrobe, pa drojë  
gjithë ushtrin' sa desha e pashë.  
Çdo grup rrij' në limonti;



vera e fshatrave të djegur  
deh ushtarë e pashallarë.  
Kurvëria tend' më tendë  
dhunon të ndershmit në nder.  
Gra të njoma, jo ushtarë,  
e longarë më tepër pashë.  
Shpata e shenjtë e Erthogrujtit  
ngjeshet keq e keq shkëlqen,  
e në ngjyhetë me gjak,  
i të tredhurve është gjaku  
a i një skllavi të trembur,  
që të zotin zemëroi.  
Mbi sixhadet e Mosulit  
shtrirë praptas m'u dëftua  
një zinxhir krejt prej floriri,  
që i ndërpliksej në qafë.  
Fustanella e mëndafshtë  
dhe e hollë i binte mbi gju  
si një vashe veshur nuse.  
Në shatore kish aq plaçkë,  
sa do të donte një grua:  
napa, kurorë dhe breza  
e fustane të qëndisur,  
asnjë shpatë, asnjë ushtë!  
E vështronin drejt në sy  
shërbëtorkatë çerkeze  
a mos e kënaqte kënga,  
apo i pëlqenin vallet,

apo pem' shtrydhur në borë  
donte që të shuaj vapën...

— Folna pak e folna drejt!  
Kur u nise, thuaj, ç'pe?

— Nëntë dit' përpara nisjes,  
një mëngjes ai kaloi  
me dy mij' kalorës prapa!

— Fol: ku vate e nga u pruar?

— Njeriu i mbyllur si varri  
ç'do të bëjë s'e kallzon.  
Di që një mbrëmje më parë  
erdh e shkruara e Dovletit;  
dhe me ëndërrën e natës,  
sado q'u fshch, m'u kallzua.  
Në mes maleve t'Moresë  
është i pasur Kaur' i Lalës;  
Ballabani vate i tha:

— Lësho dhrinë, dhrinë e bardhë  
që ka mbir' në kopshtin tënd,  
në daç kokën edhe pronën!



— Kur do kthehet? Në ushtri  
do ta sjellë vashën? — Gjegju!

— Lart nga ledhet e Beratit  
u ndie thirrma e Seb-Aliut,  
se erdh balozi i Zotit t'madh:  
shtëpi e rrugë pastrohen,  
hidhen lule dhe kurorë...

Plaku heshti dhe u lirua,  
Mbreti iu kthye Pal Golemit:

— Të qoftë truar, i tha,  
mos të t'iki, mos të t'flasë,  
mos të t'shohë asnjeri!  
Shko, dhe ta ruash me nder!

Pali doli edhe pa hir,  
se në zemër na e shpoi  
emri i Lalës e i Kaurit,  
ndërsa ai, Niku i Petës,  
kish lënë pragun ku rrinte  
e mes trimash kishte hyrë:

— Mua, mua, zot' i lartë,  
më përket' qeni i pabesë,  
se në livadhet e Petës  
qe ndyrsi e nëmë e gjëmë;  
epëm lejë sa ta shkel,  
sa të shplajmë kalbësirën,  
që në Arbëri ka mbirë...  
— Kalbësirë, — qeshi Mbreti, —  
kalbësirë përmbi qentë!  
Arbëri, i kthjellt si djelli,  
qelbësirën e përze!  
Po ti trim e bir i trimit,  
fol: veç qeni i pabesë  
zjarrin e zemrës të ndezi?  
Asgjë tjetër s'të përvëlton?  
Por u bëftë si do ti!  
Mblidhi trimat, ec e mund  
edhe vashën e çliro!  
Mbaj mend këto porosi:  
Pasi t'i kesh thyer mirë,  
ruaju, trim, guximit tënd,  
mos i ngrohëtë në gjak  
edhe i verbër në luftë,  
bie pa pritur në trap<sup>1)</sup>!  
Ndiqe armikun dhe there

---



1) trap — hendek



gjer atje ku shtrihet fusha,  
 por, sa të arrish te kodra,  
 atje te vahu i frikshëm,  
 kthehu prapa dhe thirr shokët;  
 atje i miri ngjan me t'ligun  
 dhe kot humbet trimëria.

Niku bëri një premtim,  
 që humbi në fat'n e keq.

Mjo neper ëshite një kryevepi  
 e Barës së Ri ku ai ka shkruar  
 tërë talentin dhe origjinali-  
 tetin e tij.



84

$$\begin{aligned}
 \vec{F}_{el} &= -kx & \vec{F} &= mg. \\
 F_{el} &= F = -kx & -kx &= mg.
 \end{aligned}$$

# PJESA E TRETË

## I

### LUGINA E KUSARIT

Lehtë-lehtë e qetë-qetë,  
ndërsa dita s'kishte zbardhur,  
nëpër pyll e nëpër shpate,  
nëpër gërxhe e gremina  
rridhte Niku tok me shokët.  
Udhëtarit, që i takoi  
natën, i shkretë e i vetëm,  
i ngjanë hije të prapshta  
jetës e varresh përzënë;  
bëri kryq e me pshertimë  
troi gruan e fëmijët.  
Pasi lindjes zbardhëlloi  
plot me re vetull' e ditës,  
ata zbritën që nga çukat,  
duke kërcyer shkëmb mbi shkëmb  
dhe tek lugin' e Kusarit,



më e egër, më e gryyer  
mbi përroin ngushton udhën,  
prapa drizash, prapa lisash,  
pa piptitur ata u strukën.  
Ashtu ujqit e uritur,  
që erë prej delesh ndjejnë,  
hundëngritur, tej-tëhu  
venë, ndalen e mbajnë vesh;  
pra, me bark duke rrëshqitur,  
sy e grykë zgurdulluar,  
presin shqerrat befasisht.  
Niku i vetëm mbi një shkëmb,  
si një qift me sqep çeliku,  
rri pa tundur e pa frymë;  
dhe mëngjesi po i fryn  
që prapa qafës i ftohët,  
duke i shprishur përmbi supa  
tufë-tufë t'artën grundë  
ndërsa dielli, që i derdh  
rreze plot e i bën kurorë,  
as e ngroh, as e përmend.  
Gjiri i tija llahtariset,  
edhe ballët i ndërrohen,  
posi qielli që ndrron retë,  
herë-herë, shkëlqen e qesh,  
herë-herë i vrënjtet syri.  
S'luan këmba e do t'kërcejë,  
mbahet dora e bje mbi kordhë.

— Bre! Të jet' mjegull' e lumit  
ajo që lëviz mbi fushë,  
drojë e dëm i korrësve?  
Apo rrëmben era e malit  
pluhur udhës e lëmishte?

— Jo, se lumëthi shkëlqen,  
er' e malit ka pushuar  
edhe fletët më nuk tunden.

— Po ç'të jetë ai zbardhëllim,  
andej poshtë, që të merr sytë?  
Të jen' shkrepitima të vapës,  
a reflekset e liqenit?

— Jo, janë shapka çeliku  
dhe përkrenare të arta  
e mburoja të argjendta  
me parzmorë të florinjta;  
janë trima, janë ushtarë,  
që kanë forën në ballë.  
Rend i pari mbi murgjarin<sup>1)</sup>

---

1) murgjar — kalë

Ballabani e duket div:  
i shkrepstin tmerri nga sytë,  
shpatës rrjedh gjaku i skllavit  
dhe vdekja i rri në dorë.  
Pasi Arbërin mohoi  
tek i errëti Drakul,  
ish Badheri nga të parët,  
i lëvduarë në luftë,  
i pëlqyer në këshilla.  
Po në Vlad, si u padit,  
dhe dënuar e në kyç vënë,  
çau hekurat q'ë lidhnin  
iku, dhe, rrethuar qensh,  
ndërroi vend e shokë e besë,  
krahëforti, zemërguri.  
Në të folur nuk i gjendej  
shok Badherit e u nderua.

Qeni mbret që e pëlqeu,  
lart e ngre në bujari.  
Tani q'erdhi në Valkal,  
Zoti i madh i shkroi e i tha:  
— **Shko tek** mjegulla e Lalës  
mbulon yllëthin e bardhë,  
ylln' e bardhë që do t'jetë  
dritë e gaz n'sarajet tona;  
dhe Kaurit të m'i thuash:



«Mbret i mbretërve të thotë:  
lësho dhrinë<sup>1)</sup>, dhrinë e bardhë,  
që ka mbir' në kopshtin tënd,  
në daç kokën edhe pronën».

U përgjunj Badheri e u nis  
dhe Kaurit i çoi fjalën.  
Qeni i dheut iu trua  
e të bijezën i dha.

Vajza qau, rrahu gjirin,  
shkuli flokët, u nxiros;  
por, si e urtë që më ish,  
e futi helmin në zemër,  
vetëm se iu trua zogës,  
asaj zogëzës së malit.

*Shyrtim nga  
Datiok J. D. D. D.  
E. C. D. D. D.  
R. D. D. D. D.  
1984*

*Kostaq Shemsh*  
*4891*

1) dhri — hardhi; tek arbëreshët simbolizon vashën, nusen.

kytun nga  
Atrac room Isik  
në qafshin e  
dëshirës  
Edhe qafshin  
1984  
Sakunde

II

KËNGA E ZOGËS

poç pap.

Zogë, o zogë kryezezë,  
ti je e fillme, e vetme un' jam;  
në shkretirë ti vajton,  
këtu un' qaj natë e ditë;  
ti po shokthin e kërkon,  
unë të dashurin e humba;  
jemi bashkë në mjerim,  
qofshim bashkë në liri!

Po unë e mjera, e penguar,  
nuk kam krah', s'mund të shpëtoj;  
ti me krahëzit e erës  
më rreh malet edhe fushat  
sa dëshirë të më kesh...  
Eh, po gjete shokun tënd  
edhe gëzimin e zemrës,  
shko edhe te trimi im,

Truli

te i miri, te i bukuri,  
t'i rrëfesh helmet e mia  
dhe mallin tim të pasosur,  
duke i thënë:

pasosur

— Nga ora e zezë,  
që m'u zhduke n'errësirë  
dhe u shua lehtë-lehtë  
krisma e lehtë e këmbës sate,  
ra në kopështin e Lules  
nëma e keqe, u bë shkretirë;  
gazi sosi në rënkim,  
fora e vashës në lëngim.  
Nata e ndjeu duke folur,  
duke iu truar hënës,  
hënëzës dëshmitares  
t'mallit, besës e së rremes  
n'atë kohë të paharruar,  
që nga vdekja të shpëtoi;  
edhe hëna ledhatare  
e mbuloi prej helmit ballin  
me napëzën e mjegullës  
dhe gjith brinjat u shurdhuan  
vajit e lemzës së saj.  
Dita e pa flokëprishur,  
pa kujdesje e pa haidhi  
dhe nga prindi shkarëzyer,  
dhe nga vashat e përqeshur,  
veç ajo nuk të harroi,



Kujtim  
nga Etn.

po gjithnjë me bes' të thellë  
priti, priti vitn' e parë,  
të tretin, të taksurin.  
Dhe si shkoi i treti vit  
priti prap e nuk u lodh.

p. papallo

More, i ëmbli trimi im,  
mos ke rën' ndër të vdekur  
te livadhi i pakujtuar  
dhe i helmuar nga balta  
mua të fillmen m'harrove?  
Po i vdekur ti nuk je,  
zemra ma thotë dhe e di  
se i vdekur po të ishe,  
tani do t'vije tek unë  
me ëndrrën e natësë  
edhe do më zgjidhje besën.

Po një natëz unë pashë,  
pashë Dreqëzën kaluar,  
mbi një rreze hënëtare,  
që me dorezën e bardhë  
më dëftoi vendin tënd,  
vendin tënd, të lumurin;  
e në mes dritës së saj  
zblloi një pamje t'parrëfyer,

zblloi një ditë flamurtare  
dhe, ndër flamurët e nderit,  
un' t'u fala, trim mbi trima!  
Në je gjallë, pse nuk kthehe  
te ky gji që llahtariset,  
te kjo zemërëz e thyer?  
Pse nuk vjen të më shpëtosh?  
Ja, se prindi edhe më shiti,  
si një shqerrëzë kasapit,  
ndërsa qeni më vërviti  
e më shpie me pahir  
ku s'ka mall, as nder, as besë.

O zoga ime fatmirë,  
do t'i shtosh e t'i kujtosh  
këtë lutjezën e fundit,  
që nuk duhet ta harrosh:  
Mara nga armiq rrethuar  
vjen e shkon vendeve tua,  
afër teje e ti s'e di!  
Gjersa era e maleve  
do t'ia lëmojë faqezat  
edhe shpresa e ndihmës sate  
do t'i ngjallë zemërën,  
do të vijë edhe do rrojë;  
po n'e lëntë ndihma jote,  
ti ta dish se nderi i Marës

pp  
bashk' me diellin perëndon,  
se at' mall që së pari e ngau  
moti e vdekja nuk e ndrron,  
vetëm kurmin e zvarrisur  
do të ketë i ndyri qen,  
se kjo thikëzë e fshehur,  
kjo thikë që kam në gji,  
do më ruaj' nder e besë  
dhe do të më jap' liri!

Ajo foli, zoga e ndjeu,  
shkundi krahët e këndoi  
gaz e vaj një këngëzë  
dhe gjithë mali kumboi;  
pastaj mori nga fryn era,  
kur po nisej vashëza,  
e mbi retë perëndoi.  
As u kthye që të shihte  
të ëmblat vende t'vashërisë,  
vetëm mbi varrin e s'ëmës  
qau e veten fort goditi.  
Si një delezë ndër ujq,  
e strukur fort përmbi shalë,  
e pështjellë me një shqep,  
eci ditën, eci natën,  
përshkoi maletë me borë,  
shkeli fushatë me lule,



gjersa erdhën një mëngjes  
te livadhi, që sa vente  
e ngushtohej; nga një anë  
brinja e lartë, pa udhë, e egër,  
e nga tjetëra rënkonte  
lumi i gjerë, i thellë, i zi.

Si vështroi vendin, Badheri  
rreth vërejt, u mjegullua;  
mbajti kalin, vuri veshin  
e mbi shpatën hodhi syt'...  
Por një fletëzë nuk tundej  
edhe frymë s'pipëtinte,  
nuk dukej asnjë i gjallë,  
vetëm se mullenjëza,  
mullenjëza e përroit,  
fshehur gjerdheve, këndonte —  
zë i fillëm i shkretirës  
mbi të piksurën qetsi.  
Si u qasën shokëtë,  
të shtrënguarë, krenarë,  
u kthjellua, u gëzua  
dhe, duke shpuar murgjarin,  
eci prap udhës së frikshme,  
me vashëzën gjithnjë pranë.  
Si kaloi vetëm një çast,  
një çast apo nja dy çaste,

deri te një kënd i fshehur,  
ku shkëmbenjtje udha humbi...  
fare papritur murgjari  
hundzgjerruar, veshëngritur,  
duke u dridhur, u spraps.  
Kalorësi i habitur,  
duke nëmur, u ra shporve,<sup>1)</sup>  
por murgjari, i friksuar  
gjithnjë zbythej e nuk ecte...

N'atë kohë, zoga e malit  
në të gjithë shkëmbenjt këndoi  
dhe gjithë pylli kumboi...  
Vajza e gjegji dhe i rrahu  
zemra, gjithë u gëzua  
dhe nga shalëza u hodh,  
duke nxjerrë një rënkim,  
një rënkim, një ulërimë.

Ulërimave të saj,  
një ulërimë keq e gjatë,  
gjithë shkëmbenjsh iu përgjegj;  
nga çdo shkëmb dol' një ushtar.

---

1) shpor — mamuz

Ballë për ballë me Badherin,  
mbi një kucur<sup>1)</sup> i mbështetur,  
syndezur e ballëvrenjtur,  
re e zezë plot shkretim',  
si një div Niku u duk  
dhe me zënë e bubullimës:

— Pse m'u verdhe, qen i dheut?  
Jetën tënde dhe të shokëve  
e kam të mbledhur në dorë,  
sa të vrenjtem a të bzëj  
dheu të gjithve u përpin...  
Veçse unë nder kërkoj,  
s'dua gjaknë e qenërisë;  
Hajd! Hidh shpatën e mburojën,  
lësho vajzën, pastaj ik!...

Si dëgjoi, tufë-tufë  
shkuli mjekërën Badheri  
e tërbuar hante veten,  
pa gjëmoi:

— Jakni këtu,  
këtu jakni, o vëllezër,  
thorni gruan e këmbeni  
jet' me jetë e gjak me gjak!

---

1) kucur — kërcu, trung



Njëzet trima, aq sa nxente  
vendi i ngushtë, iu vërsulën...  
Vajza e urtë, sa i shikoi,  
shpejtë e lehtë si sorkadhe  
mbi një shkëmb vrap kërceu  
dhe q'andej me thikën hequr,  
me thikëz të gjirit saj,  
e kanosurë iu kthye.  
Hundëhapët si shkretimë,  
buzëfrytur, faqendezur,  
me fustanin marrë erës  
e me thikën në dorë,  
dukej si Dreqëz e natës,  
kur stuhi e dredhuri  
shtje mbi hijet e mallkuara.  
Qentë e panë dhe ndaluan,  
syverbuar bukurisë,  
ngritur shpatat, pa lëvizur,  
posi shtatore të ngurta.  
Dhe, si mbetën edhe mbetën,  
duke vrejtur të magjepsur,  
një m'i egër a guximtar  
ndëri krahun mbi atë...

Aty zoga na këndoi  
një këngë të mallëngjyer,  
sa gjithë malet i drodhi

dhe një krismë e rënd' u ndie;  
e prej krismës, njëzet qentë  
ranë praptas përmbi truall,  
njëzet shigjetash mbërthyer.

Mbi të parëtë, që ranë,  
dyzet trima morën vend,  
po të gjithë u zvarrisën,  
gurë e balt' duke kafshuar,  
në llucë gjaku të zi.  
Kur të tjerët, q'ishin prapa,  
panë shokët pocaqisur  
edhe vdekjen krahëzezë  
që mbi kokë u fluturonte,  
bërë akull e tromaksur,  
zun' të dridhen e u kthyen.  
Buzagaz, e duke qeshur,  
ia dëftoi Niku Badherit:  
— Derëzi, pa vë re mirë  
burrat e tu si vrapojnë,  
vetëm prej vashës përzënë  
dhe prej gozhdës që shkëlqen!  
Hajd! Hidh shpatën e mburojën  
e me ta kthehu dhe ik!  
Ai dëgjoi e s'u përgjigj,  
porse befas e qëlloi  
drejt me shpatë përmbi krye.

Niku e prapsi me mburojë,  
që kumboi si këmborë  
dhe tri copë shpata u bë.  
Si e pa dorën të zhveshur,  
gjithnjë me buzën në gaz  
e përçmoi:

— I paturp!

Unë s'e dua gjakun tënd,  
gjakun tënd aq të fëlliqur;  
ti do t'ikësh do a s'do,  
i shkarzyerë si qen!

Duke folur, kapistrën  
ia pret murgjarit me kordhë,  
e shpoi dhe e goditi  
aqë shpejt, saqë Badheri  
as e pa as e dëgjoi.

I shpuar dhe i plagosur,  
edhe rrypave çliruar,  
kali u kthye si era  
e si mjegull perëndoi,  
duke shkelur mbi të vdekur,  
duke shpërndarë ushtarët,  
me kalorësin përsipër.



Kur pa veten n'udhë të turpit  
e me t'ikurit përzier, —  
se dhe shokët e pasonin  
të friksuar, — duke thirrur,  
meqë ishte zemërak,  
i bij' kokës, griste gjoksin  
duke shtënë nëmë e gjëmë,  
flokët drizë, sy zgurdulluar,  
që shkëlqenin si dy urë,  
që feksin natën nga shpella.  
Por murgjari i tmerruar  
kur i thrriste, ikte më keq.

Tanët, dalë grykës së egër,  
me kordhë në dorë e ndjekin,  
duke prerë ata të ikur,  
thelë-thelë e copë-copë.  
Por më vonë, kur Niku i thirri,  
me gjak ngopur edhe fryrë,  
vrap u mblodhën, posi ujkit  
ndaj stanit, ku kanë shqyer  
delet dhe qent' kan' përzënë.

Si u praps pak e nga pak  
krisma e luftës e bërtima,  
larg, larg te shkretëtira

vajza, si flutur e lehtë,  
poshtë shkëmbit na kërceu  
e me sytë mbushur me lotë,  
më të qeshur, më të qarë,  
posi re ndriçuar diellit,  
që shkëlqen edhe derdh shi,  
dhe me gjoksin porsi valë,  
e trishtuar dhe e skuqur,  
me zë të këputur tha:

— More trim, more bujar,  
që të varfërën, të lënë,  
të harruar në një skaj,  
duarsh të qenve e lirove  
dhe i mbrojte jetë e besë,  
nderin tim truar t'paça,  
se unë mëmëzën e humba,  
se unë prindër më nuk kam  
e vëllezrit më hanë baltë...  
Eh! Ti më qofsh mëma ime,  
ti vetë prind e vëlla,  
të më ndihsh e të më mbrosh  
posi një motërzën tënde!

. . . . .

(Këtu lypset një tjetër pjesë)

# PJESA E KATËRT

## I

### DITA E VALKALIT

Zogu natën seç rënkoi  
majë kullave të Petës  
e gjith' egërsitë e malit  
iu përgjigjën për së largu.  
Lindi dielli pa rreze,  
keq i kuq, ngjyer gjak  
në një qiell bojë hiri.  
Një ohtë<sup>1)</sup> e rëndë ra mbi bot'.  
S'frynte, s'tundej asnjë fletë,  
as një zog nuk pipëtinte,  
veç kumria e lënguar  
brumbullonte nëpër shpat  
dhe me të — një zëth i hollë,  
si këmborëz e argjendtë,  
atje lartë në ballkon.

---

1) ohtë — avull



Σ [Γ] [Δ] [Ε] [Ζ] [Η] [Θ]

Ι [Κ] [Λ] [Μ] [Ν] [Ξ] [Ο] [Π]

II

KËNGA E BERATIT

O Berat, o Berat, —  
këndoi Mara atë menatë, —  
sa të varfër ti ke lënë,  
sa të veja shkulën flokët!  
Ditë vrasmje, ditë e zezë,  
mos u kthëfsh në jetë më,  
nata e vdekja të mbuloftë,  
kurrë djelli mos të zgjoftë!  
Nga katër anët e dheut  
vijne qiftet tufë-tufë,  
nga gjithë shpellat e malit  
zbresin bisha në çdo anë;  
gjak në erë, gjak në re,  
gjak në ujë, gjak në dhe,  
gur më gur një copë mish,  
kokë e krahë trimash kish!

*Riperboq*

Zonja Mamicë atë natë  
pa një ëndërr keq të gjatë,  
se iu duk i shoqi i zbetë,  
me gjith' kurmin copëtuar;  
ai kurorëzat mbi shtrat  
i mbuloi me shqep të zi;  
hoq unazën e martesës  
dhe e ndau në dy pjesë; *para gjumës i m*  
një e mbajt, nj' asaj ia dha, *pe e Culeqes*  
pastaj humbi e gjë s'i tha.  
Natë e ditë ajo vajtoi,  
po nga varri dot s'e zgjoi.

Kështu Mara më këndoi,  
nuk këndoi, po rënkoi.  
E dëgjoi që nga dhoma  
zonja Lenë dhe e qërtoi:

— E përzishme, zonja nuse,  
t'u çel kënga sot menatë,  
mos një ëndërr të keqe  
apo të vdekurit pe?

— As m'u shfaq ëndërr e keqe,  
as të vdekurit nuk pashë,  
po kam zemërën të thyer

*Souveni për moi.*

dhe pa hir më rrjedhin lotë:  
çfardo shoh, e shoh në zi...

Obobo, ky Niku ynë,  
kur më iku m'u helmua  
dhe unazën më kërkoi!..  
Vemi, mëm', vemi në kodër  
tek zbulohen gjithë fushat,  
mbase Niku na është' kthyer!

Vanë, të zezat, në kodër  
dhe vështruan më çdo anë  
sa, me trastë e me shkop  
panë përderësin<sup>1)</sup> që qante.

— O përderësi mavri,  
paç uratën, përse qan?  
Mos kafshën të kanë vjedhur,  
kasollen të kanë djegur,  
apo yt bir të ka humbur  
në këto lufta të shkreta?

— Jo, as kafshën, as kasollen,  
as tim bir unë nuk po qaj...

---

1) përderës — lypës



Syt' e mi u bënë lumë  
që prej Arbërit kullon...

— Fol, ti zë i fatit keq, —  
thirri vasha e i ra pika, —  
ç'të keqe pe në ushtri?  
Si ra Arbëri në zi?  
Fol! Në flamurët e luftës  
qift'n e Petës a e pe?

U përgjigj aher derziu:  
— Po ju them, se dje menatë,  
atje lart në Muzëkatë  
zjenin gjëmët<sup>1)</sup>, lumbardhat<sup>2)</sup>.  
Nga gjëmët dhe lumbardhat  
gjithë dheu bubulloi  
edhe tymi i dyfekëve  
gjithë malet mjegulloi;  
nga zbardhllimi i jataganve  
gjithë fushat më shkëlqyen;  
nga gjak i ushtarëve  
lumenjtë krejt u mbuluan;

---

1) gjëmë — bubullimë, gjëmim

2) lumbardhë — gjylet

nga copat e ushtave  
bëheshin urë e stiseshin;  
sheshe shtroheshin n'Valkal  
e mbi shesh ngriheshin malet.  
Posi vala e detit bie  
e prap kthehet në thellsi,  
dhe si arat e bleruara  
tunden erës që i përkund —  
venin, vinin, duke shtënë  
gjoks më gjoks, ushtar m'ushtar.  
Po, në kohë kur lëshon qetë  
bujku edhe u jep sanë  
dhe vetë, para kalives,  
përtyp një cop' buk' me kripë,  
u ndryshua pamja e luftës,  
se nga e djathta, vetëtimë  
u sul Mbreti dhe çau gardhin,  
gardhn' e zi me patërshana.  
Tek binte kordha e rëndë,  
binin krerët posi breshër;  
ai më shkoi me tërsëllimë,  
duke i shkelur thundr' e kalit  
të vdekur e të plagosur.  
Ndërsa, në anën e mëngjër,  
Dukagjini, që e vu re,  
si një shkëmb mbi armiq ra.  
Veç në grykë, me Badherin,  
jeniçerët u shtrënguan,

të bashkuar trup më trup  
dhe mburojë më mburojë,  
posi ndonjë mur i hekurt  
i patundur dhe i tmerrshëm.

Më kot trimat, guximtarët,  
n'atë mur përpoqën kryet,  
se përdhe ran' të goditur.  
Atëherë dhjet' kalorës,  
dhjet' dragoj u ranë shporve, —  
dhjetë gjëmë në stuhi —  
në mes tyre u vërvitën,  
shtrirë ushtat si purteka.  
Rrëzuan, vranë, coptuan,  
ngritën mal këtu e atje,  
mal të vvarësh, të plagosursh,  
dhe hapën të çar' të gjerë,  
shtruan një udhë mjaft të gjatë,  
si një brazdë në të mbjella.  
Ashtu Drini i Zi në dimër,  
mbushur prrenjsh të maleve,  
vjen i fryrë e i tërbuar,  
has në ujrat e liqenit,  
i merr zvarrë, i ndan më dysh;  
e lart ngrihet dallga e bardhë  
dhe rreth rrëzave gjëmon.  
Porsi ujrat e liqenit,



që, si ndahen, prapë kthehen,  
prirën vrap e bëjnë shesh,  
sa dhe lumin e mbulojnë,  
ashtu bëri hordhi e keqe.  
Si pa që të pakt' sulmonin,  
duke u mbledhur e shtrënguar  
pas të dhjetëve u mbyll.  
Mbreti aherë e Dukagjini,  
e shpërndanë hordhinë dhe u kthyen  
dhe tok ranë mbi Badherin,  
para, mbrapa, më çdo anë.  
Copëtuar dhe shkatrruar  
qeni i ndyrë zu e u zbyth,  
por, i padërmuar krejt,  
brenda vahut u mbëlodh,  
si ariu i Tomorrit,  
që nga dhënarët përzenë,  
njërin vret e tjetrin çjerr,  
sado grisur e përgjakur,  
po pa drojë zembrës së madhe,  
tërhiqet shpatit nga doli,  
ngopur gjak e ngopur mish.

Si u ngrys, Mbreti u kthye  
me gjith' ushtarët ndaj fushës;  
na ndezi zjarret e natës,  
u kujdes për të plagosur...

— Mos, të zëntë nëma e zezë, —  
thirri Mara si e çmendur, —  
qifti i Petës a m'u mblodh,  
a e pe ndër të plagosur?

Ai heshti e s'u përgjigj.  
U verdh e, me sy në dhe,  
pikë-pikë i binin lotët.  
Vasha me një ulërimë  
drejtë shtegut m'u lëshua;  
nuk zbriti, u rrokullis  
e ndaj malesh perëndoi.

. . . . .

(Lypset edhe këtu një pjesë)

. . . . .

Gjithë natën, gjithë ditën,  
me kalorësit e mi,  
renda unë pa u ndalur  
dhe përshkova nëntë fusha,  
nëntë fusha e nëntë male,  
duke prerë, duke vrarë  
qentë e ikur, të shpëtuar,  
po kur u zhdukën të fundit  
përtej brinjës së Mokreut

*metafor*

edhe dita zu të erret,  
shokët tërhoqa dh'u ktheva.

shkalle  
Lim



Riperlo

Sa i qaseshin livadh  
vrëhej, errej zemra ime,  
velur vramjes së trazuar,  
se zjarri qe bërë hi,  
se gjith' drizat e barishtat  
ishin lyer në të kuq,  
edhe brazdat e hendeqet  
ishin plot me gjak të piksur.  
Afër vahun të Valkalit,  
tek e ashpra luftë u ndez,  
pirgje-pirgje qen' të vvarët  
e në pirgjet me të vvarë  
ujë e qena buzëndotur.  
grinin, shqyenin bark e zorrë,  
ndërsa, me britma të çjerra,  
mbulonin djellin si re  
korba, sorra e sqifterë.

Sa e bukur djalëri e kaluar  
që gjer dje përpinte retë,  
sot ka heshtur përgjithmonë, sot,  
posi pleh në dhe shpërndarë!  
Në sa trajta vdekja e shkretë  
m'u dëftua n'ato pamje!



Këtu një ushtar i ri  
mbylli sytë duke qarë:  
kujtoi nënën që e priste!  
Medet, që më kot e priste!  
Më tej armik me armik,  
kafshuar porsi dy qena,  
ende dukej se luftonin!

I trazuar, i helmuar --,  
hoqa syt' nga pamja e egër,  
ktheva sytë afër urës;  
pashë, befas, një murgjar  
me kryet ulur në truall  
dhe me frerët nëpër këmbë,  
me mutafën<sup>1)</sup> zvarrë-zvarrë  
e me shalën nën bark.

*trimi nuk  
ishite*

Iu afrova, jo pa drojtje,  
se mutafa n'ar qëndisur  
një dyshim të keq më zgjoi,  
se e qëndisur m'u duk  
me luanë në të gjelbër.

Pranë kalit, një ushtar  
me dhjetë ushta në gji  
ishite shtrir' si ka i therur.  
Shtrengonte me dhëmb' flamurin,  
mbante kordhënë në grusht.  
Me fytyrë nga qielli kthyer

1) mutafë — mbulesë e kalit

"Kënga e Sprapsme  
e Balës"

Këngë e Sprapsme  
e Balës

GALVIR  
DARR (RIU)

edhe vdekjen e përbuzte.  
Jo nga pendët e shqiponjës,  
as nga mburojë e argjendtë,  
sa nga vetullat kaleshe  
dhe nga sytë e zgurdulluar  
Pal Golemin unë e njoha.

U gëzova mos ish gjallë  
dhe e hoqa me kujdesje  
ku qe bari më i shkrifët.  
I preva rripat parzmores,  
vura dorën përmbi zemër  
nën dorë ajo më rrahu,  
Vrapova shpejt gjer te lumi,  
mora i solla një pikë ujë  
e ia hodha përmbi faqe.  
Ai u shtriq me një pshertim',  
si njeri në gjum' të rëndë,  
tundi kryet e m'u kthye,  
më njohu dhe pa mundim  
me zë të thellë më tha:

— Le të vdekurit ku janë,  
lem' të fle përgjithmonë  
te ky shtrat i nderit tim,  
këtu, ku eshtra të vvarësh,  
të vvarësh prej kësaj dore,  
përngaherë i kam kurorë.

Portreti

g g g

Këngë e  
Sprapsme  
e Balës



Handwritten signature or mark.

Handwritten text at the bottom of the page.



Na këtë flamur dhe Mbretit  
të m'i thuash këto fjalë:

*përmendësh*

- 1
- Pal Golemi edhe i vdekur
  - i tmerroi armiqt' me sy
  - dhe, si ikën ata, ra.
  - E t'u thuash shokve t'mi:

- Pal Golemi nuk ka vdekur,

- 2
- do ta ngrerë zëri i luftës
  - edhe do jenë me ju

- krahu, kordha, zemra e tij.

Tani, Balë, n'atë lis

- 3
- var mburojën e parzmoren
  - dhe përkrenaren e zezë
  - dhe mbi to var kordhën time,
  - që, kur dielli të shkëlqejë
  - dhe me rreze t'i qëllojë,
  - nga shkrepimat e tyre
  - të bijen, ngrirë nga tmerri,

gjithë ç'm'u trembën në jetë;  
dhe, në qetësinë e natës,  
hekurat edhe çeliku,  
tundur erës së Mokreut,  
do t'i ngjajnë ushtri e gjallë  
qenit qasur n'errësirë.

~~##~~  
Foli e kryet i ra në gji,  
shtrembëroi sytë, u shtri përdhe



me të gjithë trupin e tij.  
Unë u ngrita, se mbaroi  
dhe nga shokët u këtheva,  
që t'i hapnim shpejt një varr. /  
I dallova atje poshtë,  
tek sillnin një të plagosur,  
që po e mbanin në duar.  
Kur e qasën, u zalisa  
sa pashë qiftin e artë,  
sqeppërpjetë, krahëhapur,  
mbi përkrenaren prej bronci.  
Ishte i bardhë si qiri, *popullore*  
kryet i binin mbi sup,  
lëshuar flokët përdhe.  
Gjaku i rridhte pik'-pikë  
qafës së hapur si shegë.  
Jeta që mbledhur në sy.  
Si më pa me dhemshuri,  
më vështroi edhe qeshi.

— Mos më qaj, vëllathi im,  
mos më qaj në zulmën time,  
kësaj dite flamurtare  
kësaj dite t'Arbrit tënë!  
Kthehu n'ushtri dhe u thuaj,  
edhe Darës të m'i thuash:  
Malli i mirë në djalëri  
është si vaji në kandil.

Niku, dhëndërëth i ri,  
këmbeu dasmën me luftën  
dhe kangjelet me Valkalin.  
Njëqind qena m'u vërsulën,  
të njëqindët hanë baltë,  
pastaj Badher tradhëtari  
që nga prapa më qëlloi.  
E t'i thuash edhe mëmës:  
Niku u nis e do mënojë,  
po ti, mëmë, mos e prit,  
se, për birëthin që humbe,  
një bijëz ai të la;  
ta ka truarë përjetë!  
Pastaj hip përmbi ballkon  
të m'i falesh vashës bukur,  
vashës së bukur të Lalës,  
asaj që mua kujton,  
më kujton në zemërë:  
Niku yt, moj, t'u martua,  
t'u martua me një plakë,  
me një plakë keq të zezë  
e ti, e bukur, të martohesh!

*ndryshimi  
me atullosan*

*metafor*

Sosi fjalën dhe m'u shua,  
si kandili që s'ka vaj,  
si një lulëz e këputur  
që mban erë edhe e vyshkur.  
Dhe, teksa ne po mendonim

*ferchoam  
Tregon se Niki  
dhe i vdekur  
jeton*

që t'i mbulonim në varre,  
më kët' anë urës një vashë  
na u shfaq posi një hije.  
Kishte flokët të ndërlikur,  
sytë thelluar në ballë,  
me fustanin copë-copë  
e me këmbëtë përgjakur:

— O ju ushtarë, vëllezër,  
qofshi të lumtur përherë,  
mos më patë kësaj fushe  
një kalorës fort të ri,  
me përkrenare të artë,  
ku një qift i fluturon?

Floriri i saj përzihet  
me flokët e tij të verdhë  
e me ballin posi diell;  
ka dy sy si dy shkëndija,  
dy shkëndija shkrepëtime.  
E ka gojzën unazë  
edhe fjalëzën të ëmbël,  
porsi hoji i paraverës...  
Eh, ju lutem, më kallzoni!

Ne u pamë sy ndër sy,  
që na u mbytën në lot.  
Helmit buza na u qep.  
U zverdh edhe na vështroi



dhe u kthye. E, sa pa  
të vdekurin në dhe shtrirë,  
dha një britmë e i ra në krahë  
e ftohtë posi dëborë.

Vam' t'i flisnim, s'u përgjigj.

Vam' ta preknim, nuk lëvizi.

Vam' ta ngrinim e na vdiq.

Zemra e dhënë Nikut t'saj,

rritur mallit e haresë,

si u rënd nga helmi i keq,

më s'e mbajti, edhe plasi...

Në Valkal janë dy varre,

fle te njëri Pal Golemi,

e mbi të mbiu një lış

me gjithë fletët e zeza.

Fle te tjetri Nik Peta.

Vasha e Lalës i fle pranë

dhe, si u deshën në jetë,

ashtu duhen nënë dhe.

Atje mbiu një qiparis,

mbiu dhe një mollë e bardhë.

Kur zë thahet qiparisi,

thahet edhe molla e bardhë!

Mori bijë, bija e Lalës,

mori e bukur e trishtuar,

ç'më ktheve në motnë e shkuar?